



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 15/2020 regjistër (JR)  
Datë 02.06.2020

Nr. 9 i vendimit  
Datë 11.04.2022

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 11.04.2022, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUESE:** Subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Balili, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 228, datë 17.01.2020.

**BAZA LIGJORE:** Neni 62 e vijues i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë"; nenet 47, 48, 49, 51 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, si dhe parashtrimet para seancës, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Balili (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës, të miratuar me ndryshimet kushtetuese me anë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, mbante detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, Tiranë, dhe për shkak të këtij funksioni, në zbatim të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex-officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”). Për subjektin e rivlerësimit, nga Komisioni janë zhvilluar hetime vetëm për 1 (një) nga tri kriteret e rivlerësimit, përkatësisht për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin gjendet i administruar raporti i përgatitur nga ILDKPKI-ja.
2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit është konstatuar se:
  - *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.*
  - *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
  - *Ka kryer fshehje të pasurie.*
  - *Ka kryer deklaram të rremë.*
  - *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 228, datë 17.01.2020, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Balili, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar*”.
4. Vendimi për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsela Balili, është marrë nga Komisioni bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin është konkluduar se:
  - i. *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke bërë deklaram të rremë, duke fshehur burimin e vërtetë të krijimit të këtyre pasurive, duke bërë deklaram jo të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe, për rrjedhojë, rezulton se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë.*
  - ii. *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të pasurive të përmendura në këtë vendim, paragrafit 3, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.*
  - iii. *Subjekti i rivlerësimit ka fshehur dhe evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim të tij, në përputhje me paragrafin 5, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.*
5. Në përfundim, mbështetur në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, duke vendosur dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

### III. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Balili, ka ushtruar ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 228, datë 17.01.2020, me anë të të cilit ka pretenduar për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe mosqenien e saj në kushtet e cenimit të besimit të publikut, si dhe ka pretenduar se Komisioni ka kryer një vlerësim jo të drejtë të kriterit të vlerësimit të pasurisë.
7. Me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”):
  1. Shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike së bashku me provat që i bashkëlidhen ankimit.
  2. Ndryshimin ose prishjen e vendimit të Komisionit nr. 228, datë 17.01.2020, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Balili, pasi të bëhet i ditur edhe rezultati i dy kritereve të tjera.

#### A. Shkaqe të ankimit lidhur me procesin e rregullt ligjor

8. Në drejtim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhur me gjykimin e çështjes së tij nga Komisioni, subjekti pretendon se : **(i)** Procesi i hetimit i kryer në Komision vetëm mbi kriterin e pasurisë, është në kundërshtim me përcaktimet kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, si dhe cenon parimin e transparencës ndaj publikut. **(ii)** Vlerësimi, në kuptim të parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, bëhet vetëm mbi një vlerësim tërësor të procedurave (të pasurisë, figurës dhe aspektit profesional) dhe jo mbi vlerësimin e një kriteri të vetëm. **(iii)** Zbatimi i parimeve të procesit të rregullt ligjor kërkon dhënien e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për mbrojtje efektive, duke i lënë në dispozicion afatin e arsyeshëm e të nevojshëm për të përgatitur mbrojtjen dhe paraqitur provat, afat i cili, sipas subjektit, nuk i është lënë nga Komisioni, gjë e cila ka passjellë mospësigurimin prej tij të provave të nevojshme për mbrojtjen mbi rezultatet paraprake të hetimit të Komisionit. **(iv)** Moskryerja prej Komisionit e hetimeve shitesë mbi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore publike, tregon se Komisioni e kishte marrë vendimin para se të kryhej një hetim i plotë e shterues mbi kontrollin e pasurisë. **(v)** Komisioni, në mbylljen e hetimeve, nuk ka konsideruar “kushtet e posaçme ligjore”, në të cilat është gjendur subjekti përgjatë viteve 2009-2016, situatë kjo e cila nuk gjen rregullim në ligjin nr. 84/2016 e, për pasojë, duhej të interpretohej sipas parimeve kushtetuese dhe vlerave të KEDNj-së.

#### B. Shkaqe të ankimit lidhur me kontrollin e pasurisë

9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza financiare e Komisionit për pasurinë ap. 72,5 m<sup>2</sup> (blerë në vitin 2002<sup>1</sup>), është jo e saktë, për shkak: **(i)** të mospërfshirjes në analizën financiare të shumës prej 600.000 lekësh, të dhënë nga prindërit e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur për mosorganizimin e ceremonisë së martesës; **(ii)** të përfshirjes në analizën financiare të shpenzimeve të jetesës në shumën 859.729 lekë, ndërkohë që për periudhën 1998-2002, sipas subjektit, këto shpenzime të tij dhe të bashkëshortit janë mbuluar nga prindërit e tij; **(iii)** të mospërfshirjes në analizën financiare të të ardhurave të përfituara nga subjekti, për periudhën 6-mujore gjatë së cilës subjekti pretendon se ka qenë me raport paaftësie; **(iv)** të llogaritjes së gabuar të të ardhurave për periudhën e barrë lindjes nga 58.685 lekë në shifrën 43.831 lekë.

---

<sup>1</sup> Subjekti ka deklaruar në DVP dhe në d-vetting se të ardhurat e siguruar nga shitja e ap. 72 m<sup>2</sup>, janë përdorur më pas si një ndër burimet që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit “duplex” te {\*\*\*} në vitin 2012.

10. Për pasurinë apartament *duplex*, me sip. totale 196,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. {\*\*\*}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit i konsideron të padrejta dhe të pabazuara në prova dhe në ligj konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri për sa vijon.
- (i) Subjekti nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, interesat privatë ndër vite për sa i përket kontratës së prenotimit, pagesës së këstit të parë dhe kredinë e përdorur për pagimin e këtij kësti. (ii) Në DVP-2007, nuk është deklaruar marrëdhënia kontraktuale me shoqërinë {\*\*\*} ShPK, si dhe nuk provohet që fondet e siguruara nga kredia kanë shkuar për pagesën e apartamentit *duplex* me sip. 197 m<sup>2</sup>. (iii) Subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e tij, pasi në kuptim të përcaktimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk provon burimin e ligjshëm të huas së marrë nga shtetasi M. M, e cila, në mënyrë të pjesshme, është përdorur si burim të ardhurash për këtë pasuri. (iv) Nuk provohet se të ardhurat e përfituara nga shitja e ap. 72 m<sup>2</sup>, janë përfshirë si burim financimi për ap. *duplex* në qershor 2012. (v) Në 6-mujorin e parë të vitit 2012, kur janë kryer pagesat e kësteve të ap. *duplex*, nuk provohet që prej personit të lidhur të jenë disponuar si gjendje *cash* të ardhurat e siguruara nga shitja e apartamentit të motrës së tij.
11. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me analizën financiare të viteve 2010-2016 duke pretenduar se: (i) për periudhën 2010 – 2016 shuma prej 6,898,417 lekësh, e përfutuar si e ardhur nga mbështetja e familjarëve dhe puna informale në kushtet e goditjes së familjes nga shteti, është përdorur për mbulimin e shpenzimeve të përditshme, këstit të kredisë me “Raiffeisen Bank” dhe pushimet, dhe si e tillë, duhet të përfshihet në analizën financiare të kësaj periudhe. (ii) Pas vitit 2009, shuma prej 317.700 lekësh, e përfutuar si e ardhur nga mbështetja e familjarëve, ka shërbyer për kreditimin e llogarive “Futura” të fëmijëve pranë “Intesa Sanpaolo Bank” dhe, si e tillë, duhet të përfshihet në analizën financiare të kësaj periudhe. (iii) Në analizën e vitit 2012, duhet të përfshihen të ardhurat e siguruara (si dhuratë në *cash*) nga shtetasja Zh. S. M<sup>2</sup>, në vlerën 2.800 euro, shumë e cila ka shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të pushimeve të këtij viti. (iv) Moskonsiderimi në analizën financiare të Komisionit, si pakësim *cash*-i, i shumës prej (-) 194.384 lekësh në vitin 2015, është një gabim i analizës financiare i cili duhet të sistemohet nga ana e Kolegjit.
12. Subjekti pretendon se nuk është i bazuar në prova dhe në ligj konkluzioni i Komisionit se nuk ka pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit Ford Fiesta me vlerë 4.000 euro, pasi kjo makinë është financuar me një pjesë të fondeve të marra hua nga z. M. M.
13. Subjekti kundërshton si të pabazuara qëndrimet e Komisionit lidhur me mosdeklarimin në DPV-2003, nga personi i lidhur, të automjetit BMW, model {\*\*\*}, duke shprehur se ky automjet nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar në emër bashkëshortit, por është përdorur prej tij dhe një kolegj për të shkuar në vendin e punës.
14. Subjekti kundërshton si të pabazuar në ligj qëndrimin e Komisionit se ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe të pasakta të pasurisë ndër vite, referuar përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, për motoçikletat me targa {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, si dhe mosdeklarimin e përdorimit të banesës së prindërve në Vlorë.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### **A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit**

###### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

15. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione*

<sup>2</sup> Tezja e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

*materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga nenit 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Balili, vendim të cilin nëpërmjet ankimit subjekti kërkon ndryshimin e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

16. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

17. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 228, datë 17.01.2020, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Balili, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

17.1 Kolegji shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve, si dhe kërkesën për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

17.2 Kolegji e shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provës të akteve që kanë shoqëruar ankimin e tij dhe e vlerësoi atë në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkojnë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*, si edhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikohet se: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjyqimit* – dhe konstatoi se provat e paraqitura nuk plotësonin kriteret e parashikuara nga dispozitat e cituara për të gëzuar statusin e provës që mund të merret në gjykimin në apel të çështjes. Subjekti nuk ka paraqitur ndonjë provë që provon se këto nuk janë paraqitur përgjatë hetimit administrativ pa fajin e tij dhe, për më tepër, nga analiza e tyre në raport me faktet që ai synon të provojë me to, Kolegji arriti në konkluzionin se ato janë të parëndësishme për zgjidhjen e çështjes, për pasojë vendosi të mos e pranojë këtë kërkesë të subjektit.

17.3 Për sa u përket akteve të paraqitura me parashtrimet para seancës gjyqësore, Kolegji vlerëson se, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk legjitimohet që këtij akti procedural t'i bashkëlidhë akte me pretendimin për marrjen e tyre si provë dhe se afati për të paraqitur prova të reja, shtrihet maksimalisht me paraqitjen e ankimit dhe nuk mund të zgjatet përtej këtij afati.

17.4 Kolegji kryesisht, gjithashtu vlerësoi edhe nëse ekzistonin rrethana që e bënin të nevojshme kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, në kuptim të parashikimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 dhe konstatoi se nuk gjendej para asnjërës prej këtyre situatave që do ta çonin atë në vendimin për gjykimin e çështjes në seancë publike.

17.5 Kolegji, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, vendosi të vijojë ta shqyrtojë çështjen në formën e gjykimit të zhvilluar në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

## **B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit**

### ***I. Shkaqe lidhur me pretendimet për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit***

18. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në drejtim të hetimit administrativ të kryer në Komision dhe të zbatimit të parimeve të procesit të rregullt ligjor, Kolegji konstaton sa vijon.

18.1 Referuar ankimit, konstatohet se prej subjektit të rivlerësimit ngrihet pretendimi se hetimi i kryer në Komision vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, është në kundërshtim me përcaktimet kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016.

18.2 Këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, Kolegji e gjen jo të drejtë e të bazuar, pasi vjen në kundërshtim si me përcaktimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ashtu edhe me qëndrimin tashmë të konsoliduar të mbajtur në jurisprudencën<sup>3</sup> e Kolegjit për këtë çështje. Kjo dispozitë ligjore përcakton qartazi se rivlerësimi është një proces i cili jo domosdoshmërisht fillon dhe finalizohet me shqyrtimin e 3 (tri) kriterëve të procesit të rivlerësimit. Ky interpretim shihet në lidhje të ngushtë e në harmoni me përcaktimet e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, i cili në pikën 1 parashikon se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet për arritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Parashikimi i nenit 59, i cili përcakton se për konfirmimin në detyrë të një subjekti kërkohet domosdoshmërisht vlerësimi pozitiv për të tria kriteret së bashku, duke u interpretuar *a contrario* lejon përfundimin e procesit të rivlerësimit edhe mbështetur vetëm në një ose dy kriterë, për ato raste kur për Komisionin rezulton se nga hetimet e kryera për këto kriterë, subjekti nuk arrin një nivel të besueshëm, aq sa konfirmimi në detyrë nuk është më një opsion i vlefshëm.

18.3 Kolegji gjithashtu mori në shqyrtim pretendimin e subjektit se vlerësimi, në kuptim të parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, bëhet vetëm mbi një vlerësim tërësor të procedurave dhe jo mbi vlerësimin e një kriteri të vetëm.

18.4 Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstatoi se, referuar përmbajtjes së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, masa disiplinore për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit është dhënë bazuar në përcaktimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe se në vendim, nuk ka asnjë arsyetim lidhur me cenimin e besimit të publikut apo vlerësim tërësor të çështjes. Nga analizimi i vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, konstatohet se vendimmarrja bazohet vetëm mbi konkluzionet e hetimit administrativ mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin këto hetime kanë konkluduar se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe për të përballuar kostot e jetesës, si dhe ka probleme me saktësinë e deklarimeve të tij në deklaratën *vetting* (në vijim “*d-vetting*”) dhe

<sup>3</sup> Vendimi nr. 1/2019 (JR), datë 31.01.2019; vendimi nr. 3/2013 (JR), datë 07.02.2019; vendimi nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019; vendimi nr. 12/2018 (JR), datë 29.05.2019; vendimi nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019; vendimi nr. 28/2019 (JR), datë 24.10.2019; vendimi nr. 24/2021 (JR), datë 28.07.2021.

deklaratat vjetore periodike (në vijim “DVP”). Për këtë arsye, Kolegji e gjen këtë shkak ankimi të pambështetur në situatën faktike, si dhe të pabazuar në prova dhe në ligj.

**18.5** *Nga analizimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit, Kolegji konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendime që kanë të bëjnë me zbatimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor, sipas të cilave pretendon se prej Komisionit duhej t'i jepej e drejta për një mbrojtje efektive, duke i lënë në dispozicion afatin e arsyeshëm e të nevojshëm për të përgatitur mbrojtjen dhe për të paraqitur provat.*

**18.6** Lidhur me këtë shkak, konstatohet se subjekti në ankim pretendon se afati i lënë në dispozicion nga Komisioni për t'u përgatitur mbi rezultatet paraprake të hetimit, ka qenë i pamjaftueshëm dhe ka sjellë mossigurimin prej tij të provave të nevojshme për mbrojtjen. Referuar kësaj situatë, subjekti me ankimin kërkon prej Kolegjit shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me qëllim shqyrtimin e provave të reja që ajo i ka bashkëlidhur ankimit. Si situatë faktike të lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit identifikon kohën e njohjes së tij me rezultatet paraprake të hetimit administrativ, me anë të të cilave Komisioni i ka kaluar barrën e provës, përkatësisht më datë 18.12.2019, me afat deri më 06.01.2020. Këtë periudhë kohore, brenda së cilës ishin edhe festat zyrtare të fundvitit, subjekti e cilëson si të mjaftueshme për të siguruar dokumentet e nevojshme. Për rrjedhojë, subjekti pretendon se është gjendur në pamundësi objektive për të realizuar një mbrojtje efektive, në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor, sidomos për aktet e sjella nga jashtë vendit [Shtetet e bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe Gjermani], të cilat kërkoheshin me vulë apostile dhe ishte e pamundur të siguroheshin në harkun kohor 18.12.2019 - 06.01.2020.

**18.7** Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstaton se nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se subjekti i rivlerësimit, me e-mail-in e datës 06.01.2020, ka njoftuar Komisionin se lidhur me dokumentet prej ShBA-së, janë marrë vulat apostile dhe janë postuar për të mbërritur në Shqipëri; ndërsa lidhur me dokumentet prej Gjermanisë, janë njoftuar se zyrat kanë qenë të mbyllura dhe sapo të përfundojnë, do të dërgohen me postë ekspres.

**18.8** Lidhur me këtë situatë faktike, referuar akteve të administruara në fashikullin e krijuar nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ, konstatohet se as në komunikimet para dhe pas seancës dëgjimore dhe as në vendim, Komisioni nuk ka mbajtur qëndrim për moskonsiderimin e akteve të sjella nga shtete të huaja në cilësinë e provës prej subjektit, për shkak të mungesës së vulës apostile. Gjithashtu Kolegji konstaton se seanca dëgjimore është zhvilluar prej Komisionit më datë 13.01.2020 dhe në të subjekti ka paraqitur disa prova të reja që janë administruar nga Komisioni, i cili ka dhënë dhe vendimin më datë 17.01.2020.

**18.9** Në drejtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se koha, nga kalimi i barrës së provës e deri në zhvillimin e seancës gjyqësore, ka qenë e shkurtër<sup>4</sup>, Kolegji konstaton se ky pretendim është i ngritur vetëm me ankimin, pasi subjekti nuk e ka ngritur atë në Komision. Në kushtet e moskërkimit prej subjektit të kohës shtesë për përgatitjen e mbrojtjes së tij, Kolegji vlerëson se subjekti nuk e ka konsideruar veten në pamundësi objektive për t'u mbrojtur dhe nuk ka pretenduar shkelje të ndonjë të drejte e cila t'i jetë mohuar më pas nga Komisioni, duke konkluduar se këto të drejta duhen trajtuar si të rëna në dekadencë në kuptim të nenit 459, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *Në ankim nuk mund të parashtrohen kërkime të reja që nuk janë parashtruar në gjykimin në shkallë të parë.*

**18.10** Në funksion të ushtrimit të së drejtës për t'u mbrojtur, Kolegji konstatoi se subjekti i rivlerësimit përgjatë seancës dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni, ka paraqitur prova të reja për të cilat, në procesverbalin e kësaj seance, është evidentuar se janë administruar nga trupi

---

<sup>4</sup> Në ditë kalendarike, koha e lënë në dispozicion subjektit për përgatitjen e shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit, është 19 ditë, nga 15 ditë që është zakonisht kjo kohë në praktikën e punës së Komisionit.

gjykues për vlerësim para marrjes së vendimit përfundimtar. Në këto kushte, Kolegji konstaton se, përveç sa më sipër, pretendimet e ngritura në ankim nga subjekti në drejtim të cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur për shkak se koha e lënë në dispozicion nga Komisioni ka qenë e pamjaftueshme për sjelljen e provave dhe mosdhënies së mundësisë për sjelljen e tyre, referuar edhe situatës faktike që rezultoi nga aktet e fashikullit të gjykimit, gjendet një pretendim i paargumentuar. Në këto kushte, këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit Kolegji e konsideron të pambështetur në fakte dhe në ligj.

**18.11** *Subjekti ka paraqitur pretendime në drejtim të hetimit të kryer nga Komisioni, duke specifikuar se nuk janë kryer hetime shtesë lidhur me provat dhe shpjegimet e paraqitura prej tij pas kalimit të barrës së provës në seancë dëgjimore publike, gjë të cilën ai e konsideron si tregues se Komisioni e kishte paracaktuar vendimin.*

**18.12** Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstaton se në seancën dëgjimore të datës 13.01.2020, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës së re 3 (tri) akte, me të cilat synon të provojë burimin e ligjshëm të kreditimeve të llogarive “Futura” të fëmijëve të tij. Nga përmbajtja e vendimit të Komisionit, vërehet se sjellja e këtyre provave në seancën dëgjimore ka gjetur pasqyrim në vendim<sup>5</sup>, si dhe rezultoi se Komisioni ka bërë një vlerësim të tyre. Kolegji vëren se fakti që Komisioni nuk i ka vlerësuar këto prova në mënyrën e kërkuar nga subjekti, nuk mund të konsiderohet si mungesë e vlerësimit të tyre.

**18.13** *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, me hetimet e kryera, nuk ka konsideruar “kushtet e posaçme ligjore” në të cilat është gjendur subjekti përgjatë viteve 2009-2016, situatë kjo e cila nuk gjen rregullim në ligjin nr. 84/2016 e, për pasojë, duhej të interpretohej sipas parimeve kushtetuese dhe vlerave të KEDNj-së, Kolegji analizon se:*

**18.14** Subjekti, si “kushte të posaçme ligjore”, klasifikon situatën e ndodhur në vitet 2009-2016, kur ajo dhe bashkëshorti i saj kanë qenë të pezulluar nga detyra dhe në pamundësi për të filluar punë tjetër, duke pretenduar që për ato vite të mos ngarkohet me kosto për shpenzime jetese. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, ashtu siç ajo vetë parashtron, rezultoi se me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. {\*\*\*}, datë 02.12.2009, është vendosur për miratimin e ndjekjes penale dhe dhënien e autorizimit për të proceduar gjyqtaren Marsela Balili, si dhe **pezullimin** e saj nga detyra e gjyqtares, derisa vendimi të marrë formë të prerë. Në nenin 8 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar më pas me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005<sup>6</sup>, konstatohet se përfundimi i detyrimit të subjekteve për deklarin periodik të

---

<sup>5</sup> Shih paragrafin 1.18 të vendimit të Komisionit, tek i cili janë listuar të gjitha provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>6</sup> Kjo dispozitë parashikonte:

“Subjektet, për të cilat është parashikuar detyrimi për deklarin, detyrohen të deklarojnë dhe për një periudhë prej dy vjetësh **pas largimit nga funksioni**. Presidenti, Kryeministri, ministrat, deputetet, zëvendësministrat, sekretarët e përgjithshëm, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të të gjitha niveleve të gjyqësorit, prokurorët, drejtorët e përgjithshëm të institucioneve qendrore, do ta kenë këtë detyrim për një periudhë prej katër vjetësh pas largimit nga funksioni”. Kjo dispozitë u ndryshua me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i cili në nenin 15, “Llojet e interesave privatë që deklarohen, në pikën 6 parashikon:

“6. Deklarimi pas largimit nga funksioni, sipas të njëjtit kuptim të këtij termi, të shprehur në nenin 8 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, kryhet vetëm një herë, në datën e largimit nga funksioni, me përjashtim të rastit kur zyrtari fillon punë në një detyrë tjetër, që, sipas këtij ligji, vazhdon të mbartë detyrimin për deklarin”.

Në vijim, ndryshimet që iu bënë ligjit nr. 9049/2003 me ligjin nr. 85/2012, në nenin 7/1, të titulluar “**Deklarimi pas largimit nga funksioni**” parashikuan sa vijon.

“Neni 7/1

1. Deklarimi pas largimit nga funksioni kryhet vetëm një herë për periudhën nga deklarinimi i fundit deri në datën e largimit, me përjashtim të rastit kur zyrtari fillon punë në një detyrë tjetër, që, sipas këtij ligji, vazhdon të mbartë detyrimin për deklarin”.



pasurisë lidhet me largimin nga funksioni dhe, në këtë rast, ata kanë detyrimin e dorëzimit të një deklaratë specifike deklarimi, tek e cila deklarohet të gjitha pasuritë e akumuluar deri në atë moment. Referuar rastit objekt shqyrtimi, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD-së), është pezulluar nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, situatë e cila është e ndryshme nga ajo e largimit nga detyra. Në këtë kuptim, Kolegji vëren se subjekti ka pasur detyrimin për të vijuar me plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës së deklarimit të interesave periodikë me të njëjtin regjim si përgjatë ushtrimit të detyrës edhe përgjatë të gjithë kohës së pezullimit, detyrim i cili e ngarkonte atë me përgjegjësi për të deklaruar çdo ndryshim pasurie dhe burimet e krijimit të tyre.

Gjithashtu Kolegji vëren se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit do të dukej i arsyeshëm nëse përgjatë periudhës kohore që subjekti ka qenë i pezulluar nga detyra, të mos kishte ndryshime/rritje të qenësishme të pasurisë, ndërsa konstatohet se në vitin 2012, kohë në të cilën subjekti ka qenë i pezulluar nga funksioni, ai dhe personi i lidhur kanë lidhur kontratën e shitblerjes së një pasurie apartament *duplex*, me sip. 196 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë, për të cilën, siç do të arsyetohet në vijim, për asnjë nga burimet e deklaruara që kanë shërbyer për financimin e saj, nuk provon ligjshmërinë e të ardhurave. Në këto kushte, Kolegji këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit e gjen të pabazuar në prova dhe në ligj.

## **II. Analiza e shkaqeve që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

19. **Lidhur me pasurinë apartament, me sipërfaqe 72,5 m<sup>2</sup>, në Tiranë, të përfutur me kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep., datë 10.12.2002, me çmimin 3.647.384 lekë, subjekti i rivlerësimit kundërshton si jo të drejtë konkluzionin e Komisionit se nuk ka pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, konkluzion i cili ka pasur një efekt negativ në të gjithë analizën financiare. Kolegji për këtë pasuri mori në shqyrtim pretendimet e subjektit në ankim, për të cilat konstatoi se:**

19.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar pasurinë apartament me sip. 72,5 m<sup>2</sup> në Tiranë, në DVP-në e vitit 2003, si dhe ka specifikuar në *d-vetting* se të ardhurat e siguruar nga shitja e kësaj prone kanë shërbyer në vitin 2012 si një nga burimet e financimit të apartamentit *duplex* me sip. 196 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë. Nisur nga kjo situatë faktike, kur e ardhura e përfutur nga shitja e ap. me sipërfaqe 72 m<sup>2</sup> është deklaruar si një nga burimet që kanë financuar pasurinë e deklaruar në *d-vetting*, Komisioni ka kryer verifikimin dhe kontrollin e këtij burimi të ardhurash duke marrë fillimisht në analizë mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të financuar me burime të ligjshme blerjen e apartamentit me sip. 72,05 m<sup>2</sup> në vitin 2002. Rezulton se subjekti ka deklaruar në DVP-në e vitit 2003, për apartamentin sip. 72,5 m<sup>2</sup>, si burim financimi: “*Të ardhura nga paga dhe të tjera*”. Personi i lidhur (subjekt deklarues po ashtu, për shkak të funksionit si prokuror) ka deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë për këtë pasuri, si burime të financimit: *Të ardhura normale të krijuara dhe të mbledhura në vite nga ndihmesa e babit, me profesion teknik ndërtimi me licencë, vjehrrit që ka punuar disa vite në emigracion në Itali, në profesion mekanik, si dhe të ardhura modeste të mbledhura dhe të kursyera personalisht edhe nga mosbërja e ceremonisë së dasmës.*

Nga analiza e kryer, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, në momentin e blerjes së apartamentit me sip. 72,5 m<sup>2</sup>, ka qenë me mungesë të ardhurash të ligjshme në vlerën (-)1.208.274 lekë, për blerjen e tij.

19.2 Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar shpjegime<sup>7</sup> subjektit lidhur me burimet e financimit të kësaj prone, për të cilat ai ka shpjeguar se, *përveç të ardhurave nga paga, na janë dhënë të ardhura nga prindërit tanë respektivë, të ardhura të cilat në DVP-*

2. Në deklarimin pas largimit nga funksioni jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë, për periudhën nga deklarimi i fundit deri në datën e largimit nga funksioni.

3. Deklarimi kryhet jo më vonë se 15 ditë nga data e largimit nga funksioni.

<sup>7</sup> Me pyetësorin shtesë nr. 2.

2003 janë shpjeguar me fjalët “të ardhura të tjera”, kurse bashkëshorti i tij këtë të ardhur e ka deklaruar me fjalët: *të ardhura normale të krijuara dhe të mbledhura në vite nga ndihmesa e babait me profesion teknik ndërtimi me licencë, (vjehtërit) që ka punuar disa vite në emigracion në Itali me profesion mekanik [...]*. Ndërsa nga të dhënat që rezultojnë nga aktet e fashikullit të krijuar nga hetimit administrativ, Kolegji konstaton se subjekti, pasi është njohur me rezultatet paraprake të hetimit, sipas të cilave për periudhën kur është blerë apartamenti me sip. 72,5 m<sup>2</sup>, situata e tij financiare ka rezultuar me balancë negative prej (-) 1.821.025 lekësh, ai, në ndryshim nga sa ka deklaruar më parë gjatë hetimit administrativ, ka shpjeguar se të ardhurat që i janë dhënë nga prindërit, kanë shërbyer jo për blerjen e apartamentit sesa për të porositur mobilie të brendshme të tij. Më tej, ka thënë se: *të ardhurat që kanë shërbyer si burim për blerjen e ap. 72,5 m<sup>2</sup>, kanë qenë të ardhurat tona si bashkëshortë, nga punësimet tona respektive, qysh prej fillimit të punësimit tim dhe të bashkëshortit tim, kurse të ardhurat që na janë dhënë nga prindërit tanë, kanë shkuar më së shumti për mobilie të brendshme të ap. 72,5 m<sup>2</sup>.*

**19.3** Në ankim, për apartamentin me sip. 72,5 m<sup>2</sup> në Tiranë, subjekti kundërshton analizën e kryer nga Komisioni për sa i përket analizës së kryer për prindërit e tij dhe të bashkëshortit, duke pretenduar se ata kanë pasur të ardhura të ligjshme për t’ia dhuruar atij dhe bashkëshortit (shumat prej 300.000 lekësh *cash* nga prindërit e subjektit dhe 300.000 lekësh nga prindërit e personit të lidhur), të cilat nuk ka qenë përcaktuese, por kanë qenë një burim plotësues në blerjen e këtij apartamenti. Në ankim, subjekti pretendon se analiza e Komisionit e kryer për apartamentin, është e cenueshme për shkak:

- të mospërfshirjes në analizën financiare të shumës prej 600.000 lekësh, të dhënë nga prindërit e subjektit dhe të personit të lidhur për mosorganizimin e ceremonisë së martesës;
- të përfshirjes në analizën financiare të shpenzimeve të jetesës në shumën 859.729 lekë, ndërkohë që për periudhën 1998-2002, këto shpenzime janë mbuluar nga prindërit;
- të mosllogaritjes në analizën financiare të të ardhurave të përfituara nga subjekti, për periudhën 6-mujore kur ai ka qenë me raport paaftësie;
- të llogaritjes së gabuar të të ardhurave për periudhën e barrëlindjes, nga 58.685 lekë në shifrën 43.831 lekë.

**19.4** Me ankimin, në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës së re disa akte<sup>8</sup>, me anë të të cilave synon të provojë se prindërit e tij dhe të bashkëshortit kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’u dhuruar atyre shumën prej 600.000 lekësh, e cila është përdorur për blerjen e apartamentit prej 72 m<sup>2</sup> në Tiranë.

**19.5** Lidhur me këtë pretendim, Kolegji kreu analizën financiare për prindërit e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, të cilët, për të ardhurat e dhuruara sipas këtij qëndrimi të subjektit, janë konsideruar si persona të tjerë të lidhur, referuar përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në analizën e kryer nga Kolegji, u analizuan të dhënat që rezultojnë në aktet e administruara në fashikullin e krijuar nga Komisioni, për sa u përket të ardhurave të prindërve të subjektit dhe të bashkëshortit, si dhe nuk u konsideruan të dhënat e provave të

<sup>8</sup> Aktet e paraqitura me ankimin, janë përkatësisht:

- Formular i lëshuar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.01.2020, për pagën bruto dhe neto të L. P, realizuar në vitet 1999-2008 pranë DSHP Përmet (sot NJVKSH).
- Formular i lëshuar nga Spitali Rajonal Përmet, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.01.2020, për pagën bruto dhe neto të L. P, realizuar në vitet 2009-2010-2011.
- Formular i lëshuar nga ISHSH Gjirokastrë, mbi pagën bruto dhe neto të Th. P, realizuar në vitet 1996-2001.
- Formular i lëshuar nga Bashkia Përmet, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.01.2020, mbi pagën bruto dhe neto të Th. P, realizuar në vitet 2000, 2001, 2002.
- Formular i përcjellë nga Spitali Rajonal Vlorë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.01.2020, për pagën bruto dhe neto të V. B, realizuar në vitet 1994-2007.

reja të sjella me ankimin, siç është arsyetuar më sipër në këtë vendim. Kolegji çmon se subjekti nuk ka mundur të provojë se gjendet në kushtet e përcaktuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012 për paraqitjen e tyre me ankimin.

**19.6** Bazuar në aktet e fashikullit administrativ të krijuar nga Komisioni, si dhe nga analizimi i deklaratave periodike të subjektit e të personit të lidhur, si dhe i deklaratës *vetting* të subjektit, lidhur me të ardhurat në masën 600.000 lekë që subjekti pretendon se kanë qenë kontribut i prindërve të tij dhe të bashkëshortit në momentin e blerjes së ap. 72 m<sup>2</sup>, Kolegji konstaton sa vijon.

- Prej subjektit, shuma prej 600.000 lekësh nuk është evidentuar në deklaratën *vetting* si një nga burimet e financimit që ka shërbyer për blerjen e ap. 72 m<sup>2</sup> në Tiranë.
- Në DVP-në fillestare të vitit 2003, subjekti nuk ka deklaruar si burim financimi për apartamentin 72 m<sup>2</sup> shumën e dhënë si kontribut të prindërve të tij dhe të bashkëshortit, dhe as ka evidentuar ndonjë vlerë lidhur me to.
- Shpjegimet e dhëna përgjatë hetimit administrativ, gjatë të cilit evidentohet edhe vlera 600.000 lekë, si kontribut total i prindërve të subjektit dhe të personit të lidhur, është një e dhënë e pambështetur në prova, e cila ka dalë në dritë dhe është fiksuar në këto vlera në funksion të rezultatit të analizës financiare që ka kryer Komisioni.
- Nga ana tjetër, vetë shpjegimet që ka dhënë subjekti përgjatë hetimit administrativ, duke u shprehur se vlera 600.000 lekë përfaqëson<sup>9</sup> një vlerë që ka shkuar për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit, dhe fakti që në ankim ai pretendon se kjo vlerë ka qenë një prej burimeve të financimit (joprimary) për blerjen e ap. 72 m<sup>2</sup>, e bën edhe më të vështirë besueshmërinë për ekzistencën e këtij kontributi të prindërve, për të cilin vetë subjekti nuk është i qartë dhe nuk e ka identifikuar saktësisht se për çfarë i ka përdorur ato.
- Edhe pse lidhur me vlerën 600.000 lekë nuk gjenden gjurmë të deklarimit të kësaj shume si kontribut nga prindërit që shërbeu për blerjen e ap. 72 m<sup>2</sup>, në analizën ekonomike të kryer në Kolegj, bazuar në të dhënat e administruara përgjatë hetimit administrativ, është analizuar mundësia ekonomike e prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur për të kursyer respektivisht nga 300.000 lekë (në total 600.000 lekë), nga e cila rezulton se as familja e origjinës e subjektit të rivlerësimit dhe as ajo e personit të lidhur nuk kishin mundësi financiare të kursenin këto vlera për t’jua dhuruar fëmijëve të tyre.

**19.7** Nga analiza e kryer në Kolegj për mundësinë ekonomike të prindërve të subjektit dhe të personit të lidhur për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën prej 600.000 lekësh, rezultoi se edhe në versionin nëse merren në shqyrtim provat e reja të sjella nga subjekti me ankimin, sërish nuk provohet, të paktën për prindërit e subjektit, se ata kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’i dhënë në formën e kontributit, shumën 300.000 lekë në vitin 2002. Në këtë kuptim, situata negative e konkluduar nga analiza financiare e kryer në Komision, por edhe në Kolegj, në këndvështrim të provave të reja të sjella me ankimin, vetëm do të reduktohej në një vlerë të parëndësishme, por do të rezultonte sërish negative në një raport të rëndësishëm për analizën financiare që u referohet burimeve për krijimin e kësaj pasurie<sup>10</sup>.

<sup>9</sup> Në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka shprehur se: “të ardhurat që kanë shërbyer si burim për blerjen e ap. 72,5 m<sup>2</sup>, kanë qenë të ardhurat tona si bashkëshortë, nga punësimet tona respektive, qysh prej fillimit të punësimit tim dhe të bashkëshortit tim, kurse të ardhurat që na janë dhënë nga prindërit tanë, kanë shkuar më së shumti për mobilie të brendshme të ap. 72,5 m<sup>2</sup>”.

<sup>10</sup> Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, duke konsideruar informacionin e provave të reja të sjella me ankimin për mundësinë e prindërve të subjektit të rivlerësimit, rezulton se:

- Me ankimin, subjekti ka paraqitur shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.01.2020, të lëshuar nga Spitali Rajonal Vlorë, e cila na jep informacion për pagat e nënës së subjektit, znj. V. B, për periudhën 1994-2002; si dhe shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 05.02.2020, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për babain e subjektit, z. P. B, i cili na jep informacion për pagat e përfituara prej tij për periudhën 2015-2019, periudhë e cila dukshëm konstatohet se është vite pas kohës (vitit 2002) kur subjekti ka blerë apartamentin me sip. 72 m<sup>2</sup>.

- Nga analizimi i të dhënave të këtyre akteve, si dhe duke përfshirë në analizë kostot e jetesës për një familje me 4 persona, rezultojnë me mungesë të ardhurash në masën (-) **719.300 lekë**.

**19.8** Në kushtet kur Kolegji, siç është argumentuar më sipër, nuk mori për shqyrtim provat e reja të sjella nga subjekti së bashku me ankimin, konfirmon si të drejtë qëndrimin e mbajtur prej Komisionit lidhur me mospërfshirjen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, shumat e pretenduara se janë dhuruar nga prindërit, për faktin se subjekti nuk ka provuar gjatë hetimit në Komision burimet e ligjshme të krijimit të këtyre shumave, edhe pas kalimit të barrës së provës, por është mjaftuar në këtë moment procedural vetëm me deklarin e tyre, pa i shoqëruar pretendimet e tij me provat mbështetëse. Kolegji vëren se subjekti jo vetëm ka deklaruar vlerën e këtyre shumave vetëm pas marrjes dijeni të rezultateve paraprake të hetimit dhe njohjes me analizën financiare të Komisionit, duke iu përgjigjur rezultatit negativ të kësaj analize, dhe ka pretenduar se ato janë përdorur nga ai si burim për blerjen e apartamentit, në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur gjatë hetimit se kontributi i prindërve ka mbështetur familjen në mobilimin e apartamentit, por nuk ka paraqitur në këtë moment dokumentacion mbështetës për të provuar këto shpjegime dhe as ka kërkuar kohë për paraqitjen e tyre në seancën dëgjimore.

**19.9** Duke konsideruar sa më sipër, paqëndrueshmërinë në deklarime të subjektit lidhur me destinacionin e këtij kontributi të pretenduar, shumën e përcaktuar vetëm pas rezultateve të hetimit, mungesën e paraqitjes së dokumentacionit provues në kohën e kërkuar nga Komisioni, por edhe faktin se edhe në një version garantist, dokumentacioni i paraqitur nuk do të shëronte bilancin negativ të subjektit për këtë pasuri, Kolegji e gjen të drejtë të konfirmojë qëndrimin dhe rezultatin e Komisionit për mospërfshirjen e tyre në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

**19.10** *Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën e kryer nga Komisioni janë përfshirë pa të drejtë shpenzimet për kostot e jetesës në shumën 859.729 lekë, ndërkohë që për periudhën 1998-2002, këto shpenzime janë mbuluar nga prindërit, Kolegji analizon sa vijon.*

**19.11** Ky pretendim i subjektit në ankim lidhet me faktin se Komisioni ka përfshirë në analizën financiare koston e jetesës së tij dhe të personit të lidhur në shumën 859.728 lekë, për të cilën subjekti kishte shpjeguar përgjatë hetimit administrativ<sup>11</sup>, se është mbuluar nga prindërit e tij.

**19.12** Kolegji, në vijim të analizës ekonomike të kryer për prindërit e subjektit për periudhën 1998-2002, ashtu si edhe Komisioni ka konkluduar, se prindërit e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve të jetesës për një familje me 4 persona, pasi për këtë periudhë në fashikull disponohen vetëm akte që provojnë të ardhurat të ligjshme të gjeneruara nga puna e nënës së subjektit, të ardhura të cilat janë edhe më pak të mjaftueshme nëse kësaj familjeje do t'i shtohet subjekti dhe bashkëshorti i tij. Kolegji ka gjithashtu në vëmendje se një pretendim i tillë mbetet i pabesueshëm, për sa kohë që: **i)** subjekti kishte ndërtuar në këtë periudhë familjen e tij; **ii)** së bashku me bashkëshortin ushtronin profesione të mirëpaguara, në kontekstin e nivelit të pagave në vend; **iii)** bashkëshorti e ushtronte funksionin e tij jashtë qytetit ku jetonte familja e subjektit, rrethanë që e bën të pamundur, sipas një logjike të zakonshme, faktin se ai jetonte duke punuar si prokuror dhe shpenzimet për jetesë përballoheshin nga prindërit e bashkëshortes; **iv)** koha e ngritjes së një pretendimi të tillë, është vetëm pas rezultateve të hetimi.

**19.13** *Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit për korrigjimin e vlerës së përlllogaritur nga Komisioni për periudhën e barrë lindjes (nëntor 2003 deri në mars 2003), nga 29.100 lekë në shumën 58.685 lekë, Kolegji analizon sa vijon.*

---

<sup>11</sup> Në përgjigjet e dhëna për pyetësin nr. 2, subjekti ka shpjeguar se:

“[...] gjatë viteve që kam punuar si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së parë Vlorë<sup>11</sup> (2001-2002), kam jetuar në shtëpinë e prindërve dhe aty nuk kam pasur kosto jetese. Të ardhurat nga paga si gjyqtare i kam administruar vetë dhe ato kanë shërbyer si burim për blerjen e ap. me sip. 72,5 m<sup>2</sup>. Gjithashtu dhe bashkëshorti im, në fundjavë, vinte e rrinte në shtëpinë e prindërve të mi pa kosto jetese”.

**19.14** Kolegji, nga analizimi i përlllogaritjeve të përfshira nga Komisioni në “Rezultatet paraprake të hetimit”, me anë të të cilave i ka kaluar subjektit barrën e provës, konstatohet se prej tij është njohur si e ardhur nga leja e barrëindjes, shuma prej 59.170 lekësh, e ndarë kjo respektivisht në vlerën 29.100 lekë në vitin 2002 dhe pjesa prej 30.070 lekësh në vitin 2003. Referuar tabelës së rezultateve të hetimit, Kolegji vëren se pretendimi i subjektit për përlllogaritje të gabuar të lejes së lindjes, në shumën 58.685 lekë, ka një efekt minimal në analizën financiare, pasi shuma e përfituar në vitin 2002 (61 ditë  $\times$  485 lekë/ditë = 29.585 lekë) është vetëm 29.585 lekë. Kjo vlerë është lehtësisht e ndryshme nga shifra e përlllogaritur nga Komisioni, me një diferencë vetëm në 1 ditë ose në shumën 485 lekë. Pavarësisht, shuma e përfshirë në analizën financiare të Kolegjit është në vlerën 29.585 lekë, në përputhje me atë që pretendon subjekti.

**19.15** Në funksion të identifikimit të saktë të mundësisë financiare të subjektit për financimin e apartamentit të blerë në vitin 2002, Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e tij se analiza ekonomike e Komisionit për periudhën nëntor 2000 - prill 2001, duhet korrigjuar duke shtuar si të ardhur shumën 42.831 lekë, të përfituar gjatë periudhës në cilën ai ka qenë me raport paaftësie.

**19.16** Kolegji konstaton se në vendimin e Komisionit, arsyetohet se referuar pikës 1 të nenit 22 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ardhurat për sëmundje janë 70% e mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik, kur i siguruari ka deri në 10 vjet sigurim. Meqenëse subjekti ka pasur vetëm një muaj punësim, pikërisht kjo mund të ketë qenë arsyeja se përse subjekti nuk ka përfituar të ardhura për këtë periudhë.

**19.17** Nisur nga ky qëndrim i Komisionit, subjekti me ankimin pretendon se për periudhën nëntor 2000 - prill 2001 (periudhë punësimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë), ai ka përfituar të ardhura në formën e pagesës së paaftësisë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, pasi ka qenë me raport paaftësie dhe, për këtë periudhë, ai ka dorëzuar në zyrën e financës së gjykatës, raportet përkatëse. Vetë subjekti në ankim shpjegon se nëpërmjet shkresës “Kthim përgjigje”, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>12</sup>, konstatohet që mungojnë të dhënat lidhur me të ardhurat e përfituara gjatë kësaj periudhe, edhe pse subjekti ka qenë i punësuar në këtë gjykatë që prej datës 01.10.2000, ndërkohë që përgjigja nga ISSh Vlorë ka shënimin që për këtë periudhë ai figuron me paaftësi.

**19.18** Në analizë të kësaj situatë faktike, për të ardhurat e pretenduara nga subjekti për periudhën nëntor 2000 - prill 2001, Kolegji, në referim të shkresës së lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, konstaton që mungojnë të dhënat e kësaj periudhe.

Gjithashtu “Vërtetimi për bazën e vlerësuar”, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Vlorë, në seksionin “Shënime”, jep informacionet se:

- Për muajt tetor dhe dhjetor 2000, emri i subjektit nuk figuron në listëpagesë.
- Në muajin nëntor 2000, figuron me mbiemrin “B.” (vlerë 23.316 lekë).
- Në muajt janar – shkurt 2001, figuron me paaftësi, por nuk ka të evidentuara ditët dhe pagesën, si dhe figuron me mbiemrin “B.”.
- Në muajin mars 2001, emri i subjektit nuk figuron në listëpagesë.

**19.19** Në tabelën e pagave, në “Vërtetimin për bazën e vlerësuar” për vitin 2001, muaji prill rezulton me pagë mbi të cilën është derdhur kontributi në masën 23.316 lekë (shifër e njëjtë me muajin nëntor 2000). Meqenëse në këtë vërtetim jepen të dhëna mbi të ardhurat vetëm për dy muaj, Komisioni me të drejtë ka përlllogaritur sipas legjislacionit në fuqi, pagën neto, duke aplikuar mbi këto dy shifra tatimin në burim dhe kontributin për sigurimet shoqërore. Pas kësaj përlllogaritjeje, Kolegji konstaton se për muajt nëntor dhe prill, pagat neto janë në total

---

<sup>12</sup> Kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 26.12.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

43.831 lekë<sup>13</sup>. Kolegji konstaton se kjo vlerë (shuma prej 43.831 lekësh) është përfshirë nga Komisioni në analizën financiare të subjektit për periudhën 1998-2000.

**19.20** Nga sa më sipër, Kolegji konkludon se pretendimi i subjektit për përfitim të siguruar nga “paaftësia në punë”, për periudhën dhjetor – mars (pasi nëntor dhe prill figuron me pagë), rrëzohet pjesërisht nga vërtetimi i ISSh-së, tek i cili konfirmohet se subjekti ka qenë në kushtet e paaftësisë për punë në muajt janar dhe shkurt 2001, por nga institucioni (gjkata) nuk ka të evidentuara ditët dhe pagesën e përlllogaritur për paaftësinë në punë. Të dyja institucionet konfirmojnë mungesën e përlllogaritjeve për këtë periudhë dhe, në të tilla kushte, përlllogaritjet e Komisionit duke aplikuar legjislacionin në fuqi për përlllogaritjen e sigurimeve dhe tatimit në burim mbi pagën mbi të cilën llogariten kontributet, për të ardhurat e kësaj periudhe, në masën **43.831 lekë**, konsiderohen të drejta prej Kolegjit.

**19.21** Në përfundim të sa analizuar më sipër, edhe pas korrigjimit me të dhënat e sipërpërmendura të analizës ekonomike të prindërve të subjektit dhe të personit të lidhur, nga analiza ekonomike e kryer në Kolegji, subjekti i rivlerësimi, për blerjen e ap. 72 m<sup>2</sup> në Tiranë, në vitin 2002, rezulton në mungesë të burimeve të ligjshme në masën **(-)1.207.789 lekë**.

**19.22** Në këto kushte, Kolegji konkludon se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 72,5 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë e të blerë në vitin 2002, nga shitja e të cilit janë përfituar të ardhura të deklaruara si burim për financimin e pasurisë apartament *duplex*, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 20. Lidhur me shkakun tjetër që ka të bëjë me pasurinë apartament “duplex”, me sip. totale 196,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. {\*\*\*}, Tiranë, për të cilën subjekti i rivlerësimi i konsideron jo të drejta dhe të pabazuara në prova dhe në ligj konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri, se: (i) Subjekti nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, interesat privatë ndër vite, për sa i përket kontratës së prenotimit, pagesës së këstit të parë dhe kredisë së përdorur për pagimin e këtij kësti. (ii) Në DVP-2007, nuk është deklaruar marrëdhënia kontraktuale me shoqërinë {\*\*\*} ShPK, si dhe nuk provohet që fondet e siguruara nga kredia kanë shkuar për pagesën e apartamentit “duplex”, me sip. 197 m<sup>2</sup>. (iii) Subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e tij, pasi në kuptim të përcaktimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk provon burimin e ligjshëm të huas së marrë nga shtetasi M. M, e cila, në mënyrë të pjesshme, është përdorur si burim të ardhurash për këtë pasuri. (iv) Nuk provohet se të ardhurat e përfituara nga shitja e ap. 72 m<sup>2</sup>, janë përfshirë si burim financimi për apartamentin “duplex”, në qershor 2012. (v) Në 6-mujorin e parë të vitit 2012, kur janë kryer pagesat e këstit të ap. “duplex”, nuk provohet që prej personit të lidhur të jenë disponuar si gjendje cash, të ardhurat e siguruara nga shitja e apartamentit të motrës së personit të lidhur.**

**20.1** Në analizë të pretendimit të subjektit, situata faktike paraqitet si vijon.

- Nga aktet e administruara nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar se personi i lidhur A. P, më datë 12.12.2007, ka lidhur me shoqërinë ndërtimore {\*\*\*} ShPK një “Akt – Marrëveshje”<sup>14</sup> për blerjen e një apartamenti me sip. totale 196,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “Komuna e Parisit” Tiranë.

<sup>13</sup> Llogaritja është bërë si vijon.

- Tatimin në burim, në masën 500 lekë + 5% x 3.316 lekë = 666 lekë.
- Sigurimet shoqërore, në masën 7,7% të tavanit 9.540 lekë = 735 lekë.
- Paga 23.316 lekë - 666 lekë - 735 lekë = 21.916 lekë në muaj.
- Përlllogaritjet për muajt nëntor 2000 dhe prill 2001, janë në total: 21.916 lekë x 2 = 43.831 lekë.

<sup>14</sup> Kjo aktmarrëveshje tregon në faqen e parë logon e kompanisë {\*\*\*} ShPK dhe rezulton se noterja publike E. T, me vërtetimin noterial nr. {\*\*\*} rep., datë 12.12.2007, ka vërtetuar se palët nënshkruan në praninë e saj aktmarrëveshjen dhe vërteton nënshkrimin e tyre në bazë të ligjit për noterinë.

- Kjo aktmarrëveshje nuk është deklaruar në DVP-2007 të subjektit të rivlerësimit dhe as të personit të lidhur, edhe ky në atë periudhë subjekt deklarues.
- Në *d-vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë shpjegim/citim/deklarim, mbi aktmarrëveshjen e datës 12.12.2007.
- Nga tërësia e përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje, në të cilën palët cilësohen si “porositësi” dhe “i porosituri”, rezulton se vetë marrëdhënia e krijuar konsiderohet si një kontratë porosie.

**20.2** Në ankim, lidhur me konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, interesat privatë ndër vite (konkretisht në DVP-2007) të pagesës së këstit të parë për apartamentin *duplex* në Tiranë, me sip. totale 196,5 m<sup>2</sup>, Kolegji konstaton se subjekti parashtron të njëjtat shpjegime me ato të dhëna prej tij në Komision, pasi është njohur me rezultatet paraprake të hetimit administrativ, duke shprehur se prej tij dhe bashkëshortit nuk është deklaruar kontrata e porosisë së apartamentit *duplex* në deklarimin periodik të vitit 2007, me arsyetimin se ndryshimi në pasurinë e paluajtshme është i lidhur me konceptin e pronësisë. Sipas subjektit, deklaratat periodike të pasurisë kërkojnë të pasqyrohen ndryshimet e pasurisë së paluajtshme dhe, sipas konceptit se pronësia mbi pasurinë e paluajtshme i kalon personit kur fitohet e drejta e pronësisë mbi të, ai nuk ka deklaruar në DVP-2007, aktmarrëveshjen për blerjen e apartamentit *duplex* në vitin 2007, por nuk ka pasur asnjë qëllim për ta fshehur atë.

**20.3** Lidhur me këtë qëndrim të subjektit si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në ankim, konstatohet se fakti i mosdeklarimit në DVP-2007, jo vetëm i aktmarrëveshjes së lidhur me shoqërinë {\*\*\*} ShPK, por edhe i pagesës së këstit të parë për apartamentin *duplex*, konsiderohet prej tij se ka ndodhur pasi nuk ka pasur detyrimin për deklarim të këtyre fakteve, në kushtet kur kjo aktmarrëveshje nuk ka sjellë për të ndryshim apo shtim të pasurisë së paluajtshme. Me të njëjtën logjikë, subjekti shpjegon në ankim se edhe pagesa e këstit të parë, prej 40.000 eurosh, me burim nga kredia e marrë në Raiffeisen Bank, nuk ka sjellë ndryshim të pasurisë së paluajtshme, si dhe sjell në vëmendje se marrja e kredisë është deklaruar nga momenti i marrjes në DVP 2007 e në vijim.

**20.4** Kolegji e konsideron këtë pretendim të subjektit jo të drejtë e të pabazuar në ligj dhe që vjen në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), i cili në nenet 4<sup>15</sup> dhe 21<sup>16</sup> parashikon se subjektet që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe të interesave privatë, duhet të deklarojnë detyrimet financiare që kanë ndaj personave juridikë. Në këto kushte, Kolegji çmon se lidhja e kontratës së porosisë së apartamentit *duplex* prej personit të lidhur në dhjetor të vitit 2007 dhe kryerja e pagesës po në këtë kohë e këstit me vlerë 40.000 euro, është një situatë që qartazi pasqyron lindjen e detyrimeve financiare të subjektit deklarues ndaj një personi juridik, siç është {\*\*\*} ShPK. Në këtë kuptim, pagesa e

<sup>15</sup> Në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, parashikohet:

“Subjektet deklarues duhet të deklarojnë detyrimet financiare të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj”.

<sup>16</sup> Në nenin 21 të ligjit nr. 9049/2003, parashikohet:

“Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshe madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit.

Deklarimi duhet të përmbajë edhe faktin nëse deklaruesi/sja ka ose jo persona të tjerë të lidhur. Deklaruesit, përpara deklarimit, duhet t'i jepen të gjitha këshillimet e nevojshme për plotësimin e deklaratës dhe t'i bëhen të njohura rrjedhimet që mbart deklarimi i rremë”.

këstit të parë përbën një ndryshim të pasurisë, për sa kohë që ky veprim pakëson gjendjen e pasurisë likuiditet duke e transferuar atë në favor të një personi juridik, por ndërkohë dhe marrja përsipër e pagimit të diferencës së çmimit, përfaqëson një detyrim financiar të lindur për subjektin e rivlerësimit në kohën e lidhjes së aktmarrëveshjes. Të tilla rrethana vlerësohen se ishin të detyrueshme për t'u deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007, dhe mosdeklarimi i tyre prej subjektit ë rivlerësimit, jo vetëm që përfaqëson një shkelje të detyrimeve që vijnë nga ligji i kohës, por vlerësohen edhe si rrethana që vështirësojnë procesin e rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për sa kohë rezulton e pamundur të krahasohen e verifikohen rreth vërtetësisë së tyre, deklarimet në d-*vetting* për këtë moment, përderisa nuk ka gjurmë të deklarimeve rreth këtij fakti në kohën e ndodhjes së tij, siç presupozohet nga ligji se duhej të kishte.

**20.5** Lidhur me sa analizuar më sipër, e gjithë situata e mosdeklarimit të kontratës së porosisë me shoqërinë {\*\*\*} ShPK në deklaratat periodike, si dhe e pagesës së këstit të parë dhe e shlyerjes në vitet pasardhëse të detyrimit financiar ndaj kësaj shoqërie, pavarësisht se nuk e ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë subjektin në kuptim të procesit të rivlerësimit dhe të vendosjes së masës disiplinore në ngarkim të tij, vlerësohet nga Kolegji si një konstatim i drejtë i Komisionit, ai që subjekti në vite nuk ka përmbushur detyrimet që mbartte si subjekt deklarues prej ligjit nr. 9043/2003, mospërmbushje e cila afekton procesin e rivlerësimit për sa i përket verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve në d-*vetting*, si edhe në drejtim të vlerësimit të plotë të kriterit të vlerësimit të pasurisë. Kjo situatë e bën të pamundur krijimin e bindjes për vërtetësinë e deklarimit të subjektit në d-*vetting*, se fondet e siguruar nga kredia kanë shkuar në dhjetor të vitit 2007 për pagimin e këstit të parë të ap. *duplex*.

**20.6** Lidhur me shkakun e ankimit nëpërmjet të cilit subjekti pretendon se nuk është i drejtë vlerësimi i Komisionit për mosdeklarimin në DVP-në e vitit 2007 të marrëdhënies kontraktuale me shoqërinë e ndërtimit {\*\*\*} ShPK, si edhe konkluzioni se subjekti i rivlerësimit nuk provon që fondet e siguruar nga kredia kanë shkuar për pagesën e ap. "duplex" me sip. 197 m<sup>2</sup>, Kolegji analizon sa vijon.

**20.7** Nga analiza e akteve të administruara, rezulton se situata faktike lidhur me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me shoqërinë {\*\*\*} ShPK paraqitet si vijon.

- Komisioni përgjatë hetimit administrativ, ka administruar dokumentacionin e sjellë nga Raiffeisen Bank lidhur me kredinë e marrë pranë kësaj banke nga personi i lidhur në vitin 2007, në shumën 40 000 euro.

- Nga ky dokumentacion, është konstatuar se qëllimi i dhënies së kredisë nga Raiffeisen Bank është për blerje apartamenti, dhe si kontratë porosie në këtë bankë, me qëllim marrjen e kredisë nga personi i lidhur, është paraqitur një kontratë sipërmarrjeje (porosie) nr. {\*\*\*} prot., datë 27.9.2007, me sipërmarrës shoqërinë {\*\*\*} ShPK, me objekt blerje apartament banimi (3+1), me sip. totale 128,2 m<sup>2</sup>, me adresë: seksioni {\*\*\*}, pozicioni lindje, nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, Tiranë, me vlerën 64.000 euro. Referuar kësaj kontrate, citohet se kësti i parë, në vlerën 10.000 euro, do të likuidohet në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate. Kësti i dytë, në vlerën 50.000 euro, do të likuidohet deri në datën 10.11.2007. Kësti i tretë, prej 4.000 eurosh, nga pjesa e mbetur do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit.

- Subjekti i rivlerësimit, përgjatë hetimit administrativ, ka shpjeguar se pasi është disbursuar kredia bankare në shumën 40.000 euro: (i) i është paguar shoqërisë {\*\*\*} ShPK, nëpërmjet dorëzimit në *cash* në zyrën e financës së shoqërisë; (ii) kontrata e sipërmarrjes (porosisë) nr. {\*\*\*} prot., datë 27.9.2007, me sipërmarrës shoqërinë "San Tara" ShPK dhe porositës personin e lidhur, A. P, nuk ka prodhuar pasoja juridike për palët. Qëllimi i hartimit të kontratës ka qenë për të bërë të mundur tërheqjen/disbursimin e kredisë bankare prej 40.000 eurosh në Raiffeisen Bank.

- Me provat e përcjella Komisionit përgjatë hetimit administrativ, subjekti ka treguar se apartamenti për të cilin personi i lidhur ka lidhur kontratën e porosisë me nr. {\*\*\*} prot., datë



27.9.2007, me sipërmarrës shoqërinë {\*\*\*} ShPK, nuk ka kaluar asnjëherë në pronësi të tyre pasi ky apartament pikërisht në ditët kur është disbursuar kredia, i është shitur një personi tjetër<sup>17</sup>.

**20.8** Lidhur me qëndrimin e mbajtur në vendimin e Komisionit për mosdeklarimin në DVP-2007 të kontratës së porosisë me shoqërinë ndërtimore {\*\*\*} ShPK, si dhe me mosprovimin e faktit se fondet e marra me anë të kredisë nga personi i lidhur, në shumën 40.000 euro, në vitin 2007, kanë shkuar për pagimin e kështit të parë të apartamentit *duplex*, me sip 197 m<sup>2</sup>, subjekti ka pretenduar se:

(i) Kontrata mes shoqërisë {\*\*\*} ShPK dhe personit të lidhur nuk është formalizuar me noterizim, sikundër është kontrata e lidhur me shtetasen D. D.

(ii) Kredia 40.000 euro nuk është disbursuar më datë 30.07.2007, por është disbursuar më datë 30.10.2007 dhe është tërhequr *cash* nga personi i lidhur në datën 31.10.2007, në shumën 39.470 euro.

(iii) Kontrata e kredisë bankare nr. {\*\*\*}, datë 18.10.2007, për shumën 40.000 euro, është nënshkruar rreth 2 javë para se të disbursohet dhe të tërhiqet shuma në *cash* e rrjedhur nga kjo kredi, në vlerën 39.470 euro, ndryshe nga sa shpreh Komisioni se kjo kredi është disbursuar më datë 30.07.2007.

(iv) Kontrata e personit të lidhur me shoqërinë e ndërtimit {\*\*\*} ShPK, datë 29.09.2007, është bërë vetëm dy javë përpara se të lidhet kontrata e kredisë me Raiffesien Bank, datë 18.10.2007, gjë e cila, sipas subjektit, shkon në logjikën e shpjegimeve se kjo kontratë ka pasur qëllim vetëm marrjen e kredisë dhe disbursimin e saj, dhe jo blerjen e apartamentit në Yzberisht.

(v) 1 (një) ditë përpara se personi i lidhur të tërhiqte shumën në *cash* (datë 31.10.2007), shoqëria {\*\*\*} ShPK ka lidhur kontratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., datë **06.11.2007**, me shtetasen D. D për shitjen e apartamentit me sip. 128 m<sup>2</sup>, për të cilin kishte lidhur kontratë me personin e lidhur A. P. Në kontratën noteriale të lidhur me znj. D. D, përcaktohet se: *kësti i parë, në vlerën 34.650 euro, është likuiduar nga ana e blerësit; kësti i dytë, me vlerën 80.000 euro, që është pjesa e mbetur e vlerës së apartamentit, do të paguhet në momentin e dorëzimit të ambientit me çelësa në dorë.*

(vi) Kronologjia e ngjarjeve në mënyrë të logjikshme nuk provon që nga personi i lidhur është tërhequr kredia më 30.07.2007 dhe se në kohën kur është disbursuar kredia, më datë 30.10.2007, ky apartament, nga shoqëria ndërtuese {\*\*\*} ShPK, i ishte shitur shtetasen D. D, e cila për këtë qëllim kishte paguar edhe kështin e parë.

**20.9** Në analizë të rrethanave të faktit, konstatohet *së pari*, se subjekti ka dështuar të provojë se fondet e siguruara nga kredia e marrë në tetor 2007 nga Raiffeisen Bank, janë përdorur për të paguar kështin e parë të shoqërisë {\*\*\*} ShPK për blerjen e apartamentit *duplex* me sip. 197 m<sup>2</sup>. Rezulton se në momentin e marrjes së kësaj kredie, e vetmja kontratë në fuqi ka qenë ajo e prenotimit të një apartamenti me sip. 128 m<sup>2</sup> me shoqërinë {\*\*\*} ShPK. Lidhja e kontratës së shitjes së apartamentit me sip. 128 m<sup>2</sup> nga kjo kompani, jo me personin e lidhur, por me shtetasen D. D, nuk jep përgjigje për faktin nëse është kryer ose jo më parë pagesa e këtij kësti prej personit të lidhur dhe as tregon se si kanë rrjedhur ngjarjet mes palëve. Nga praktika e sjellë nga shoqëria {\*\*\*} ShPK përgjatë hetimit administrativ, nuk rezulton asnjë e dhënë lidhur me pagesat për llogari të kontratës që kjo kompani ka lidhur me personin e lidhur dhe as jepen të dhëna mbi arsyet e prishjes së kësaj marrëdhënieje kontraktuale, për të cilën vetë subjekti deklaroi se është lidhur vetëm në funksion të marrjes së kredisë.

**20.10** Pavarësisht se nga të dhënat e administruara gjatë hetimit<sup>18</sup>, të krijohet bindja se blerësi final i kësaj pasurie nuk është personi i lidhur apo subjekti i rivlerësimit, ato nuk japin

<sup>17</sup> Shtetasen D. D.

<sup>18</sup> Nga të dhënat e administruara përgjatë hetimit administrativ, përkatësisht kontrata e lidhur ndërmjet shoqërisë {\*\*\*} ShPK dhe shtetasen D. D për blerjen e apartamentit me sip. 128 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, Tiranë, për të

informacion bindës e të qartë rreth kohëzgjatjes së ekzistencës së kontratës, arsyeve të zgjidhjes së saj, pagesave ose jo të ndonjë prej detyrimeve kontraktore, zgjidhjes së pasojave të prishjes së kontratës, duke e bërë të pamundur në këtë kuptim, përfshirë faktin e mosdeklarimit në DPV-në e vitit 2007 të kësaj marrëdhënieje, kontrollin e vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë rrethanë.

**20.11** Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji konstaton se kjo situatë, pra të provuarit se apartamenti i porositur te shoqëria {\*\*\*} ShPK nuk është blerë nga personi i lidhur, nuk provon apriori faktin tjetër se fondet e kredisë të tërhequra më 31.10.2007, janë përdorur për pagesën e këstit të parë të ap. *duplex*, me sip. 197 m<sup>2</sup>, në favor të shoqërisë {\*\*\*} ShPK, jo vetëm për shkak të mosdeklarimeve në vite të subjektit, por edhe për shkak të faktit se kjo pagesë duket se është e vetmja, ndonëse në vlerë më të madhe, e mbetur pa dokumentuar prej shoqërisë “Haxhiu” ShPK. Ndërsa subjekti dhe shoqëria kanë arritur të ruajnë dhe dorëzojnë në Komision dokumentacion që provon pagimin e kësteve të mëvonshme të çmimit të apartamentit, subjekti dështoi të provojë pagimin e këtij kësti në rrethanat që ai pretendon. Përfundimisht, në lidhje me këtë shkak ankimi, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë e të paplotë një prej burimeve të financimit të ap. *duplex*, pikërisht kredinë prej 40.000 eurosh, të përfiturat prej Raiffeisen Bank, duke qenë se mungesa e deklarimeve në vite të fakteve juridike që ndryshonin interesat e tij pasurorë, në shkelje të detyrimeve ligjore, krahas mungesës së dokumentacionit provues për vërtetësinë e deklarimeve në *d-vetting*, e çojnë Kolegjin në konkluzionin se këto deklarime mbeten të pasakta, për sa kohë që nga procesi verifikues i tyre, ato mbeten të paprovuara për shkak të sjelljes në vite e përgjatë procesit të subjektit të rivlerësimit.

Ndërsa Kolegji sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur në mënyrë të konsoliduar tashmë se deklaratimet e pasakta në deklaratat periodike nuk përbëjnë një shkak të drejtpërdrejtë për deklarimin e pamjaftueshëm të subjektit, veçon se mosdeklaratimet me korrektësi në vite të subjektit të rivlerësimit, e afektojnë procesin e tij të rivlerësimit në drejtim të pamundësisë së verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve në *d-vetting*, të cilat prezumoheshin për shkak të ligjit se duhej të mbështeteshin e provoheshin me anë të deklaratave periodike. Për këto arsye, Kolegji e gjen të pasaktë e të paplotë deklarimin e subjektit në *d-vetting*, lidhur me përdorimin e kredisë si një burim për financimin e ap. *duplex*.

**20.12** Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë lidhur me deklarimin e kredisë në shumën prej 40.000 mijë eurosh, marrë prej tij dhe personit të lidhur nga Raiffesisen Bank në vitin 2007, si një burim për financimin e një pjese të çmimit të blerjes së kësaj pasurie, në *d-vetting* sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se subjekti dështoi të provojë në deklarimin e tij se kredia e marrë prej Raiffeisen Bank në vitin 2007, është përdorur për shlyerjen e këstit të parë të çmimit të apartamentit *duplex*, ndodhur në Tiranë. Konsideruar parashikimet e nenit Ç, pika 5 dhe nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të cilat përcaktojnë se barra e provës në këtë proces, për faktet e deklaruara në të, i takon subjektit të rivlerësimit, Kolegji vlerëson se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se ai dështoi të provojë këtë pretendim të tij, pasi, konsideruar të gjitha rrethanat që rezultojnë nga aktet e dosjes, subjekti nuk ishte bindës në drejtim të faktit se kredia e marrë prej tij është përdorur si burim për financimin e këstit të apartamentit në vitin 2007.

**20.13** Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti dështoi të provojë se kësti prej 40.000 eurosh, i paguar për shlyerjen e një pjese të çmimit të blerjes së

---

*cilin më parë kishte lidhur kontratë porosie edhe personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, rezulton se ky apartament në kohën që personi i lidhur ka kryer tërheqjen e fondeve të kredisë së Raiffeisen Bank, më 31.10.2007, t'i jetë shitur nga shoqëria znj. D., e cila ka kryer edhe pagesën e një pjese të vlerës së 2 apartamenteve për të cilët kishte lidhur kontratë.*

kësaj pasurie, ishte financuar prej kredisë së marrë në vitin 2007 nga Raiffeisen Bank, duke u gjendur për pasojë në situatën financiare të mungesës së burimeve të ligjshme për kryerjen e kësaj pagese në masën (-) 3.176.647 lekë, situatë e cila e vendos atë në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**20.14** Kolegji mori në shqyrtim pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se nuk është i drejtë qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit subjekti për këtë pasuri gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e tij, pasi në kuptim të përcaktimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk provon burimin e ligjshëm të huas së marrë nga shtetasi M. M, e cila në mënyrë të pjesshme është përdorur si burim financimi për blerjen e kësaj prone<sup>19</sup>, duke analizuar si vijon.

**20.15** Referuar vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se z. M. M, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, është konsideruar person tjetër i lidhur dhe për të, është kryer hetim në drejtim të verifikimit të burimeve të ligjshme të krijimit të shumës së marrë hua nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Nga ky hetim, Komisioni ka konkluduar se prej personit tjetër të lidhur nuk provohet se ka pasur burime të ligjshme për krijimin e shumës prej 40.000 eurosh në vitin 2011.

Në d-*vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se një nga burimet e përdorura për blerjen e apartamentit *duplex*, me sipërfaqe 197 m<sup>2</sup>, ka qenë edhe huaja në shumën prej 40.000 eurosh, e marrë pa dokument nga shtetasi M. M, në vitin 2011. Në d-*vetting*, subjekti ka deklaruar se kjo hua, e cila është marrë me qëllim hapjen e një aktiviteti fitimprurës nga bashkëshorti, është përdorur pjesërisht për blerjen e banesës, ap. *duplex*, në vitin 2012.

**20.16** Nga analizimi i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit, Kolegji konstaton se në DVP-në e vitit 2011 (që ka formatin pas largimit nga detyra, të plotësuar në datën 20.03.2011), subjekti nuk e ka deklaruar huan e marrë nga M. M, por e ka deklaruar atë në DVP-në e vitit 2012, e cila është një dokument që nuk është gjendur fizikisht në ILDKPKI, por që i është vënë në dispozicion Komisionit nga vetë subjekti. Lidhur me këtë fakt, subjekti i ka paraqitur Komisionit një vërtetim që tregon se ajo ka dorëzuar në ILDKPKI DVP-në e vitit 2012, por se ky dokument nuk posedohet fizikisht nga ky institucion. Në këto kushte, rezulton se Komisioni të gjithë analizën e ka kryer duke u bazuar në të dhënat e DVP-2012, të depozituar në Komision prej vetë subjektit, duke pranuar deklaratimet e bëra në të si të njëjta me ato që presupozohet se subjekti ka kryer realisht kur është plotësuar kjo deklaratë, por pa pasur mundësi të kryejë një konfrontim mes përmbajtjes së këtyre akteve.

**20.17** Në DVP-2012, lidhur me huan e marrë nga bashkëshorti prej shtetasit M. M në vitin 2011, subjekti ka deklaruar se: 14.000 euro nga huaja janë përdorur si burim financimi për ap. *duplex*; 4.000 euro janë përdorur për blerjen e automjetit Ford Fiesta dhe se 22.000 euro të kësaj huaje janë përdorur për rregullime dhe mobilim të banesës. Të njëjtat deklarime lidhur me destinimin e kësaj huaje, subjekti i ka bërë edhe në d-*vetting*.

---

<sup>19</sup> Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

Apartament banimi, sip. 101,2 m<sup>2</sup> dhe sip. 95 m<sup>2</sup>, blerë sipas kontratave nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.06.2012 dhe nr. 871 rep., nr. 427 kol., datë 25.06.2012, në rr. “Komuna e Parisit”, pall. {\*\*\*} (ose {\*\*\*}), godina {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, Tiranë. Vlera 125.000 euro. Pjesa takuese 50%.

Burimi i krijimit:

- Kredi bankare prej 40.000 eurosh, sipas kontratës bankare {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 18.10.2007.
- Vlera 61.000 euro, e përfituar nga shitja e apartamentit sipas kontratës së shitjes nr. {\*\*\*}, datë 26.9.2012.
- Vlera 14.000 euro, e shlyer nga shuma e marrë hua në vitin 2011, nga shtetasi M. M, për qëllim të hapjes së një aktiviteti fitimprurës nga bashkëshorti, por që u përdor për banesën.
- Vlera prej 10.000 eurosh, e mbetur e pashlyer sipas kontratës së huas nr. {\*\*\*}, datë 25.6.2012.

**20.18** Në mënyrë të detajuar në ankim, lidhur me huan e marrë nga M. M, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur mangësi në hetimin administrativ të Komisionit, të cilat konsistojnë në faktin se:

(i) Komisioni duhej të sqaronte natyrën e marrëdhënies së huas dhe saktësimin e konsiderimit të shtetasit M. M si individ apo si ortak i një shoqërie tregtare.

(ii) Në varësi të marrëdhënies së vendosur me huadhënësin prej Komisionit duhej të kryhej hetim mbi ligjshmërinë e të ardhurave të huadhënësit dhe analiza financiare mbi mundësinë e tij për të dhënë hua shumën 40.000 euro.

(iii) Subjekti sqaron se prej tij janë paraqitur përgjatë hetimit administrativ, si provë, ekstrakti i shoqërisë {\*\*\*}, si dhe *statement*-e të llogarive bankare pranë BKT-së për periudhën 01.01.2011 - 31.12.2012 dhe pranë Bankës Credins, për periudhën 22.02.2007 - 31.12.2013, në funksion të provueshmërisë së gjendjes financiare të z. M. M (si ortak i vetëm i shoqërisë), i cili për shkak të xhiros së kryer në kuadër të aktivitetit, ka provuar se ka pasur plotësisht mundësitë financiare të huazonte shumën 40.000 euro te personi i lidhur, dhe jo për të provuar se huaja është marrë nga shoqëria. Subjekti pretendon se faktin që tregon se marrëdhënia e huas ka qenë me individin M. M dhe jo me shoqërinë që ai zotëron ({\*\*\*} ShPK) e ka deklaruar në DVP-në e vitit 2012.

**20.19** Për sa i përket pretendimit të subjektit se hetimi i Komisionit ka pasur mangësi në drejtim të sqarimit të natyrës së marrëdhënies së huas dhe saktësimin e cilësimit të shtetasit M. M (si individ apo si ortak i një shoqërie tregtare), Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk mund t'u adresohet organeve të rivlerësimit, por ai është një detyrim që i përket subjektit të rivlerësimit i cili duhet të jetë i qartë dhe i saktë në përcaktimin e marrëdhënieve të tij me persona të tjerë; nga e cila kanë buruar të drejta pasurore. Për më tepër, Komisioni ka ftuar subjektin të japë shpjegime për këtë marrëdhënie, me kalimin e barrës së provës nëpërmjet rezultateve të hetimit në zbatim të përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, dhe ajo ka mbajtur qëndrimin se burimi i krijimit ë pasurisë së dhënë hua lidhet me aktivitetin tregtar të shoqërisë<sup>20</sup> {\*\*\*} ShPK, tek e cila është ortak z. M. M.

**20.20** Në ankim, në ndryshim nga sa ka pretenduar përgjatë hetimit, subjekti ka ngritur pretendimin se si burim i krijimit të shumës prej 40.000 eurosh, duhet të konsiderohen të ardhurat e personit tjetër të lidhur si individ. Për këtë qëllim, subjekti shpjegon se, pas dhënies së vendimit të shkarkimit nga Komisioni, huadhënësit M. M<sup>21</sup> iu kërkua të provonte huan me të ardhura të ligjshme dhe ai në këtë fazë, arriti të sigurojë dokumentacionin<sup>22</sup>, të cilin subjekti e ka paraqitur në cilësinë e provës së re me ankimin.

**20.21** Lidhur me këtë dokument të paraqitur me ankimin, në cilësinë e provës së re, ashtu siç ka analizuar më sipër në këtë vendim për shkaqe e tjera të ankimit, Kolegji konstaton se

---

<sup>20</sup> Në shpjegimet mbi "Rezultatet e hetimit" të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: "Së dyti, fakti se nuk është deklaruar dividend nga huadhënësi në kuadrin e aktivitetit të tij tregtar, nuk mund të rëndojë mbi huamarrësin, duke e konsideruar huan të prejardhur nga burime të paligjshme. Mungesa e dividendit i përket veprimtarisë dhe përgjegjësisë së pavarur të huadhënësit, krahasuar me marrëdhënien që ai vendos me huamarrësin. Mungesa e dividendit e vesh huan me vellon e paligjshmërisë për huadhënësin, por ajo nuk mund t'i ngarkohet automatikisht huamarrësit, për sa kohë huamarrësi është në mirëbesim se aktiviteti tregtar ushtrohet rregullisht. Është jashtë një kujdesi të zakonshëm të huamarrësit, të verifikojë bilancet e shoqërisë përpara se të marrë huan, apo të verifikojë marrëdhëniet e shoqërisë me zyrën e tatimeve, me qëllim që huaja e marrë të jetë pa "të meta"."

<sup>21</sup> Në ankim, subjekti i rivlerësimit shpreh gjithashtu se: "Pritet të sigurohet kthim përgjigje nga DRTT për të vërtetuar të ardhura të realizuara nga M. M për periudhën që nuk janë gjetur në listëpagesat e lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Arkivi Qendror". Bashkë me ankimin, gjendet një rikërkesë drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve /Qendra e Shërbimit të tatimpaguesve, Tiranë, e datës 16.03.2020.

<sup>22</sup> Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare me nr. {\*\*\*} prot., datë 10.03.2020, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtorja e Arkivit Qendror, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, ku vërtetohen të ardhurat e realizuara nga M. M, mbi bazën e të cilave janë derdhur kontributet nga subjekti {\*\*\*} ShPK për periudhën prill 2004 - dhjetor 2007 dhe maj 2010, shtator 2010, shkurt – mars 2011.

subjekti nuk shpjegon, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, cilat janë rrethanat që nuk i kanë mundësuar atij paraqitjen e kësaj prove në Komision dhe, për më tepër, konstaton se ky pretendim është ngritur për herë të parë në ankim dhe nuk është paraqitur para Komisionit si një burim për t’u verifikuar, duke u konsideruar si një pretendim/kërkesë e rënë në dekadencë sipas parashikimit të nenit 459, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile. Përveç sa më sipër, Kolegji vlerëson se qasja e subjektit të rivlerësimit, i cili shfaq dukshëm mungesë koherence në deklaratimet e tij edhe për sa i përket marrëdhënies me personin tjetër të lidhur, z. M. M, natyrës së kësaj marrëdhënieje, mosdeklarimit të saj në kohën e lindjes, mospërcaktimin e qartë të burimit të krijimit të pasurisë së dhënë hua, duke ndryshuar përcaktimin e saj në varësi të nevojave të mbulimit të rezultateve të hetimit apo vendimit të Komisionit, e bën të pabesueshëm edhe në këtë kuptim pretendimin e ngritur në ankim se, si burim i të ardhurave, duhen konsideruar jo ato të fituara nga aktiviteti shoqërisë {\*\*\*} ShPK, por ato që ky person ka krijuar si individ bashkë me familjen tij. Në këtë kuptim, Kolegji e gjen të pambështetur pretendimin e paraqitur në ankim mbi devijimin e përcaktimit të burimit të krijimit të pasurisë dhe marrjen e provave të reja në funksion të provimit të këtij burimi të deklaruar rishtas.

**20.22** Pavarësisht sa më lart, për analizimin sa më të plotë të këtij shkakut ankimi, Kolegji kreu një analizë të re të mundësisë ekonomike të z. M. M si individ, për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën e dhënë hua personit të lidhur në vitin 2011. Nga kjo analizë, e bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, Kolegjit i rezultoi, po ashtu si edhe Komisionit, se huadhënësi M. M nuk ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme shumën prej 40.000 eurosh, të dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, as si individ dhe as si ortak i shoqërisë {\*\*\*} ShPK. Edhe në versionin nëse Kolegji do të konsideronte marrjen në cilësinë e provës të akteve të sjella me ankimin prej subjektit, sërish të dhënat që ato ofrojnë, nuk provojnë se z. M. M si individ, kishte të ardhura të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e tij të jetesës dhe për të akumuluar në vitin 2011, shumën 40.000 euro të dhënë hua.

**20.23** Përfundimisht, lidhur me sa më sipër, Kolegji konkludon se subjekti ka dështuar të provojë burimet e ligjshme të krijimit të shumës prej 40.000 eurosh, të deklaruar se është marrë hua prej personit tjetër të lidhur, z. M. M, duke mos përmbushur detyrimin e parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit, për pasojë ai gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pagesën e shumës prej 14.000 eurosh, si një pjesë e çmimit të blerjes së pasurisë, duke e përdorur si burim këtë hua, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**21** *Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk është i drejtë konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit:*

*i. Nuk provohet që prej subjektit të rivlerësimit e bashkëshortit të tij, në 6-mujorin e parë të vitit 2012, kur janë kryer pagesat e këstit të ap. duplex dhe se janë disponuar si cash të ardhurat e siguruar nga shitja e apartamentit të motrës së personit të lidhur.*

*ii. Subjekti i rivlerësimit nuk provon se të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit 72 m<sup>2</sup> në Tiranë, janë përfshirë si burim financimi në qershor 2012 për ap.duplex me sip. 197 m<sup>2</sup> në Tiranë.*

**21.1** Lidhur me burimet e financimit të ap. duplex, me sip. 197 m<sup>2</sup>, në Tiranë, subjekti i rivlerësimit në d-*vetting*, përveç burimeve të financimit të siguruar nga kredia në Raiffeisen Bank dhe huas së marrë nga z. M. M, ka deklaruar se kanë shërbyer edhe të ardhurat në shumën 61.000 euro, të përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 72 m<sup>2</sup>, në Tiranë, sipas kontratës së shitjes nr. rep. {\*\*\*}, datë 26.9.2012, blerëses N. P.

**21.2** Në ankim, subjekti shpjegon se: [...] likuidimi i ap. “duplex” (përveç kredisë në vlerë 40.000 euro, të paguar më datë 12.12.2007) ka ndodhur në periudhën shkurt 2012 - gusht 2012, duke kryer pagesa para dhe pas lidhjes së kontratave të shitjes së ap. “duplex”, në një total prej 70.000 eurosh, shumë e cila është derdhur në llogarinë bankare të shoqërisë ndërtuese duke e cilësuar me përshkrimin që i korrespondon vetëm të vërtetës “derdhje/pagese/këst apartamenti, dhe për afërsisht deri në vlerën që mendohej se do të shitej ap. me sip. 72,5 m<sup>2</sup>. Apartamenti në pronësi të subjektit të rivlerësimit, me sip. 72,5 m<sup>2</sup>, i është shitur znj. N. P, e cila e ka blerë atë në vlerën 61.000 euro, shitje e cila është finalizuar pas çlirimit të këtij apartamenti nga barra siguruese pranë Raiffesen Bank.

Në këto kushte, është bërë pagesë në shumën 70.000 euro, e cila shkon dhe me deklarin e bërë nga subjekti i rivlerësimit në DVP-në e vitit 2012, referuar burimit të blerjes së ap. “duplex”, në vlerën 61.000 euro, e përfituar nga shitja e apartamentit në pronësi.

Në momentin e shitjes së ap. 72,5 m<sup>2</sup>, shuma e përfituar nga shitja prej 61.000 eurosh shkoj për të zëvendësuar shumën e përdorur nga shuma 84.000 euro, që i përkiste E. Ll, dhe në këtë mënyrë prej subjektit të rivlerësimit u bë zëvendësimi i shumës brenda vitit 2012.

Referuar përdorimit të kësaj shume, subjekti, gjatë procesit, ka paraqitur një deklaratë noteriale të datës 01.03.2020, të znj. E. LL dhe z. G. Ll përpara noterit publik në {\*\*\*/ShBA, në të cilën ata shprehin që kanë dhënë pëlqimin për përdorimin e shumës që u përkiste duke u shprehur: [...] Kur u shit apartamenti në vitin 2011, ne kemi lejuar burrin e motrës /baxhanakun A. P të përdorte një pjesë të parave tona sa të rregullonte punën me bankën e tij në Shqipëri.

**21.3** Në kushtet kur konstatohet se shitja e pasurisë, ap. 72 m<sup>2</sup>, është kryer rreth tre muaj më vonë nga blerja e ap. duplex me sip. 197 m<sup>2</sup>, për një analizim më të plotë të këtij shkak ankimi, si dhe të verifikimit të burimeve të financimit të deklaruara në d-*vetting*, që janë përdorur për blerjen e ap. duplex. Kolegji fillimisht analizoi kronologjikisht ecurinë e realizmit të pagesave të çmimit të këtij apartamenti, si dhe tërheqjet bankare të realizuara nga personi i lidhur të vlerës së shitjes së ap., me sip. 72 m<sup>2</sup>.

**21.4** Sipas dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ nga Union Bank dhe Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave, personi i lidhur A. P ka kryer derdhje në shumën prej 70.000 eurosh në llogarinë e shoqërisë {\*\*\*} ShPK, të detajuara si më poshtë.

- Në datën 13.2.2012<sup>23</sup>, shumën 10.000,00 euro, me përshkrim: “depozitë në llogari për këst apartamentesh A. P”.

- Në datën 20.6.2012, shumën 10.000,00 euro, me përshkrim “këst apartamenti”, derdhje nga A. P.

- Në datën 13.7.2012, shumën 10.000,00 euro, me përshkrim “derdhje në llogari për pagesë këst apartamenti”, nga A. P.

- Në datën 19.7.2012, shumën 10.000,00 euro, me përshkrim “depozitë në llogari për pagesë këst apartamenti, A. P”.

- Në datën 6.8.2012, shumën 20.000,00 euro, me përshkrim “derdhje për këst apartamenti, z. A. P”.

- Në datën 7.8.2012, shumën 10.000,00 euro, me përshkrim “derdhja e fundit e kështit të apartamentit, z. A. P”.

**21.5** Ndërsa, sipas dokumentacionit të administruar nga Komisioni, për sa i përket likuidimit nga blerësja N. P e apartamentit prej 72 m<sup>2</sup>, të çmimit prej 61.000 eurosh, në favor të personit të lidhur, rezulton se prej tij pagesat janë bërë me transaksione bankare në një shumë totale prej 59.940 eurosh, me transfertat në shumat dhe datat si vijojnë.

- Në datën 27.9.2012, shuma e transferuar 27.447,00 euro.

- Në datën 28.9.2012, shuma e transferuar 12.629,00 euro.

<sup>23</sup> Transaksion ky i pacituar në shkresën e DPPP-së.

- Në datën 1.10.2012, shuma e transferuar 7.750,00 euro.
- Në datën 1.10.2012, shuma e transferuar 12.114,82 euro

**21.6** Më tej, nga aktet e administruara, rezulton se personi i lidhur ka kryer tërheqje në shumën totale 59.800,00 euro, të detajuara si më poshtë.

- Në datën 2.10.2012, shuma e tërhequr 20.000,00 euro.
- Në datën 15.10.2012, shuma e tërhequr 10.000,00 euro.
- Në datën 2.11.2012, shuma e tërhequr 10.000,00 euro.
- Në datën 12.11.2012, shuma e tërhequr 500,00 euro.
- Në datën 5.12.2012, shuma e tërhequr 300,00 euro.
- Në datën 13.12.2012, shuma e tërhequr 19.000,00 euro.

**21.7** Referuar të dhënave të mësipërme për pagesën e ap. *duplex* nga personi i lidhur, rezulton se pjesa më e madhe e pagesave të kësteve nga ana e blerëses së apartamenti me sip. 72 m<sup>2</sup>, znj. N. P, ka përfunduar pas përfundimit të likuidimit të kësteve të ap. *duplex* nga bashkëshorti i subjektit dhe, për më tepër, nga të dhënat bankare rezulton se ky i fundit, vlerën e përfituar nga shitja e apartamentit 72 m<sup>2</sup>, rezulton se e ka tërhequr në periudhën tetor - dhjetor 2012, kohë në të cilën ai kishte përfunduar pagesën e ap. *duplex* dhe madje e dispononte atë të regjistruar si pronë në emrin e tij.

**21.8** Kolegji vëren se në përgjigje të kësaj situate faktike, subjekti i rivlerësimit përgjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe në ankim, ka pretenduar se pagesat e kësteve të apartamentit, nga shkurti deri në gusht të vitit 2012, janë kryer me fondet që personi i lidhur kishte mundësi të aksesonte dhe që ishin siguruar nga shitja e apartamentit të motrës së tij. Nga të dhënat bankare, rezulton se personi i lidhur ka kryer tërheqje në *cash* nga llogaria e motrës përgjatë vitit 2011, të cilat Kolegji i konstaton se nuk rezultojnë të jenë deklaruar nga subjekti në DVP-në e vitit 2011 si gjendje *cash* në banesë<sup>24</sup>, të disponueshme prej tij. Pagesat për ap. *duplex*, rezultojnë të jenë kryer në periudhën shkurt - gusht 2012, nëpërmjet bankës, si derdhje në llogarinë e firmës {\*\*\*} ShPK dhe jo me transfertë bankare nga llogaria në emër të personit të lidhur A. P, tek e cila u krye kalimi nga blerësi i apartamentit të motrës (P. K), të vlerës prej 84.000 eurosh. Në përshkrimin e asnjë prej këtyre pagesave, personi i lidhur nuk ka cituar burimin e këtyre fondeve, me prejardhje nga shitja e apartamentit të motrës. Nga ana tjetër, nga analizimi i DVP-së së vitit 2012, rezulton se nuk ka asnjë gjurmë të deklarimit të këtij transaksioni apo të kthimit të kësaj shume te zotëruesit e saj.

**21.9** Ky pretendim është ngritur gjithashtu për herë të parë pasi subjektit i ka kaluar barra e provës lidhur me këtë burim, duke e vendosur gjithashtu këtë pretendim në një nivel deklarativ e të paprovuar me dokumentacion të kohës. Vlen të sillet në vëmendje se deklaratat noteriale të motrës dhe bashkëshortit për lejimin e përdorimit të kësaj shume për interesa të personit të lidhur, datojnë gjatë procesi të rivlerësimit dhe duket se kanë pasur për qëllim vetëm konfirmimin e pretendimit të subjektit në funksion të këtij procesi. Vlera e tyre provuese, e cila mbetet e kufizuar sipas një jurisprudence të konsoliduar tashmë të Kolegjit, nuk arrin të bindë trupën gjyqesore për vërtetësinë e deklarimeve që ato përmbajnë.

**21.10** Nga gjithë kjo situatë faktike, Kolegji vlerëson se subjekti nuk ka mundur të provojë se personi i lidhur ka pasur të drejtën e përdorimit të fondeve të siguruara nga shitja e apartamentit të motrës së tij, për pasojë Kolegji e konsideron të drejtë dhe të bazuar në prova dhe në ligj konkluzionin e Komisionit se subjekti nuk ka mundur të provojë me dokument ligjor justifikues të drejtën e përdorimit të shumës prej 84.000 eurosh nga personi i lidhur.

<sup>24</sup> Në ankim (faqe 14), subjekti i rivlerësimit shpjegon:

“Në vitin 2011 subjekti dhe personi i lidhur nuk e kanë përdorur këtë shumë për nevojat e tyre, prandaj nuk ka pasur se çfarë të deklarohej”.

**21.11** Kolegji vlerëson se situata faktike, e përshkruar më lart, evidenton bindshëm faktin se e ardhura e siguruar nga shitja e apartamentit, me sip. 72 m<sup>2</sup>, nuk ka shërbyer si një burim për financimin e ap. *duplex* në Tiranë, ashtu sikurse deklaroi subjekti në *d-vetting*, meqenëse ajo rezultoi të jetë krijuar dhe zotëruar efektivisht nga subjekti pas shlyerjes së çmimit të blerjes për këtë pasuri. Në këto kushte, Kolegji çmon se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti ka bërë deklarime të rreme në deklaratën e pasurisë *vetting* lidhur me deklarin si burim të këtyre të ardhurave.

Për më tepër, në kushtet kur mbetet deklarativ pretendimi i subjektit se janë përdorur për shlyerjen e kësteve, paratë e disponuara përkohësisht nga shitja e pasurisë së motrës së personit të lidhur dhe në mungesë të zotërimit efektiv të të ardhurave nga shitja e apartamentit 72 m<sup>2</sup>, në referim të analizës financiare të kryer në Kolegj, në të cilën nuk konsiderohen këto para si burim për financimin e apartamentit, ai gjendet edhe në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, në masën (-)13.883.622 lekë, për krijimin e tij referuar këtij burimi.

**21.12** Në përfundim të analizës së këtij shkaku, Kolegji konkludon se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pagimin e shumës prej 61.000 eurosh, si një pjesë e çmimit të blerjes së pasurisë, në kohën e kryerjes së kësaj pagese, në vitin 2012, si edhe në kushtet e deklarin të rremë për sa i përket burimit të përdorur për financimin e kësaj pagese, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, gëmat “b” e “ç” të ligjit nr. 84/2016.

- 22** Pas vlerësimit të çdo elementi të verifikueshëm lidhur me pasurinë ap. *duplex*, të ndodhur në Tiranë, Kolegji arrin në konkluzionin e njëjtë me Komisionin, se subjekti gjendet në kushtet e deklarimeve të pasakta dhe të mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, gëmat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.

**22.1** *Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk është i bazuar në prova dhe në ligj konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit Ford Fiesta, me vlerë 4.000 euro, pasi ai pretendon se kjo makinë është financuar me një pjesë të fondeve të marra hua nga z. M. M, të cilat duhen konsideruar si të ligjshme, Kolegji analizon sa vijon.*

**22.2** Së pari, sillet në vëmendje qëndrimi i mbajtur prej këtij trupi gjykues, lidhur me konsiderimin si të paprovuar me burime të ligjshme të krijimit të shumës prej 40.000 eurosh, deklaruar si hua prej personit tjetër të lidhur, z. M. M, në paragrafin 20.23. Në këtë kuptim, përdormi si burim krijimi i vlerës 4.000 euro prej kësaj shume për financimin e automjetit, mbetet një deklarin i paprovuar i subjektit dhe, për pasojë, konfirmohet qëndrimi i Komisionit se subjekti nuk kishte mundësi financiare për justifikimin e krijimit të kësaj pasurie, në vlerën prej (-)13.883.622 lekësh.

**22.3** Në funksion të një vlerësimi tërësor e të garantimit të një gjykimi të drejtë, Kolegji vlerësoi edhe mundësinë potenciale për dhënien e kësaj huaje nën optikën e provave të reja, nga analiza e të cilave rezultoi se përsëri subjekti nuk do e rikuperonte dhe shëronte diferencën negative të konstatuar prej Komisionit<sup>25</sup>.

---

<sup>25</sup> Nga kjo analizë e kryer në Kolegj, edhe në versionin nëse do të pranohej që për huadhënësin M. M, subjekti gjendej në kushtet e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, dhe do të konsiderohej e drejtë marrja e tyre në shqyrtim në cilësimin e provës së re në gjykimin në apel, nga informacioni që këto shkresa sjellim në drejtim të të ardhurave të ligjshme të huadhënësit si individ, rezultoi se: (i) Huadhënësi M. M, nga vitit 2004 deri në vitin 2011, ka pasur mundësi për të krijuar me të ardhura të ligjshme vetëm shumën 1.193.393 lekë (ekuivalente me shumën 8.629.02 euro, konvertuar me kursin 1 euro = 138,3 lekë), tek e cila nuk janë të përfshira as kostot e jetesës për të dhe familjarët, për shkak të mungesës së informacionit në aktet e administruara. (ii) Nëse nga vlera 1.193.393 lekë, zbriten shpenzimet e jetesës për 1 (një) person, për periudhën 2004 – 2011, të cilat janë në vlerën 1.095.426 lekë, shuma e krijuar me të ardhura të ligjshme me burim nga paga që huadhënësi ka pasur në dispozicion për t’ia dhënë hua personit të lidhur të subjektit në vitin 2011, në versionin më të mirë të kësaj analize mbetet në vlerën 97 967 lekë, e cila është e pamjaftueshme për të financuar blerjen e automjetit Ford Fiesta.



**22.4** Në vijim të konkluzionit të mësipërm lidhur me mungesën e ligjshmërisë së burimit të krijimit të huas prej 40.000 eurosh të marrë prej shtetasit M. M, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**23** *Lidhur me pretendimin e subjektit, me anë të të cilit ai i kundërshton si të pabazuara qëndrimet e Komisionit lidhur me mosdeklarimin në DPV-2003 të automjetit BMW, model {\*\*\*}, nga personi i lidhur, i cili në atë kohë nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar në emër të tij, Kolegji analizon sa vijon.*

**23.1** Lidhur me automjetin BMW, model {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit me ankimin, pretendon se ligji nr. 9049/2003 i asaj kohe nuk parashikonte deklarimin e pasurisë në përdorim apo në posedim, përveç atyre në pronësi. Detyrimi për të deklaruar përdorimin apo posedimin e sendit/pasurisë ka lindur në vitin 2016, me ligjin nr. 84/2016.

**23.2** Mosdeklarimi i përdorimit të automjetit BMW {\*\*\*} në *d-vetting*, ka ndodhur pasi, referuar ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit në këtë deklaratë ka detyrimin të deklarojë të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting* dhe se në këtë moment, ky automjet nuk ishte as në pronësi e as në përdorim të subjektit të rivlerësimit apo të personit të lidhur. Nga dokumentacioni i administruar nga DRSHTRr-ja, lidhur me këtë automjet, rezulton se në të gjendet kontrata e dhurimit nr. {\*\*\*}, datë 10.4.2004, sipas së cilës dhuruesi A. S, shtetas gjerman, i dhuron personit të lidhur, z. A. P, automjetin tip BMW.

**23.3** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 në lidhje me këtë automjet, subjekti i rivlerësimit deklaron se në vitin 2003, bashkëshorti i tij ka qenë i punësuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, dhe nevojat për lëvizje i mbulonte me një automjet, tip BMW, model i vjetër {\*\*\*}. Në vitin 2004, bashkëshorti filloi të përdorte automjetin tip BMW, me targa {\*\*\*}, vit prodhimi 1993, i cili më vonë ka dalë jashtë përdorimit dhe ka përfunduar për skrap. Targat e automjetit, për neglizhencë, nuk janë dorëzuar në kohën e duhur për të kryer çregjistrimin e automjetit tek autoritetet përkatëse. Subjekti në Komision rezulton se ka paraqitur vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 11.11.2019, lëshuar nga DRSHTRr-ja, i cili vërteton heqjen e përhershme nga qarkullimi, në datën 31.12.2017, të automjetit tip BMW, me targa {\*\*\*}.

**23.4** Në analizë të këtij pretendimi, Kolegji konstaton se, në vlerësim të akteve që janë administruar prej DRSHTRr-së, rezulton se automjeti i sipërcituar është hequr përfundimisht prej qarkullimit në vitin 2017, në zbatim të ligjit nr. 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”. Sipas shkresës së ardhur nga ky institucion dhe parashikimit të nenit 12 të ligjit 33/2017, rezulton se heqja nga qarkullimi e automjeteve, në zbatim të këtij ligji, ndodhte për ato automjete për të cilat nuk është kryer asnjë veprim pas datës 31 dhjetor 2011 e në vijim. Në këto kushte, konsideruar përmbajtjen e shkresës së sipërcituar dhe parashikimet ligjore, konsiderohet se ekziston prezumimi ligjor se automjeti nuk ka qenë i konsiderueshëm si një send në qarkullimin civil në ditën e plotësimit të *d-vetting*, për pasojë mosdeklarimi prej subjektit të rivlerësimit i kësaj pasurie, duket se vjen në përputhje me frymën e ligjit të sipërcituar dhe nuk vlerësohet se duhet konsideruar si një shkelje në kuadër të procesit të rivlerësimit. Mosdeklarimi i kësaj pasurie në vitin 2004 prej personit të lidhur, ndonëse konsiderohet si një shkelje e detyrimeve ligjore të kohës, ligjit nr. 9043/2003, nuk përbën një shkelje që mund të afektojë procesin e rivlerësimit të subjektit. Për këto arsye, trupi gjyqësor e gjen të drejtë pretendimin e subjektit lidhur me këtë konkluzion të Komisionit dhe qëndrimin e Komisionit të gabuar.

**24** *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, me anë të të cilit ai kundërshton konkluzionet e Komisionit për motoçikletat me targa {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, për të cilat sqaron se nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore, por janë deklaruar në deklaratën vetting, duke pretenduar se vetëm mungesa e kësaj të dytës mund ta vendosë subjektin në kushtet e një deklarimi të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, Kolegji analizon sa vijon.*

**24.1** Në vendimin e Komisionit për motoçikletat me targa {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, është konkluduar:

*Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit, me mosdeklarimin e dy motomjeteve me targa {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe të pasakta të pasurisë ndër vite, referuar pikës 11, nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit mbart detyrimin të deklarojë të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në zotërim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.*

**24.2** Në ankim, lidhur me këto dy motoçikleta, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ato nuk janë deklaruar në deklaratat periodike, meqenëse vlera e paguar për to ka qenë më pak se 300.000 lekë dhe subjekti ka vlerësuar se nuk kishte detyrim për deklarimin e tyre. Për motoçikletën me targa {\*\*\*}, në ankim subjekti i rivlerësimit shpreh se është deklaruar në deklaratën vetting dhe se mosdeklarimi i tij në deklaratën periodike të vitit 2012, nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi.

**24.3** Nga analizimi i d-vetting dhe i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, Kolegji vëren se:

**24.4** Në d-vetting rezulton të jetë deklaruar vetëm motoçikleta me targë {\*\*\*}, ndërsa motoçikletat me targa {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, nuk rezultojnë të jenë deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike. Në kushtet kur motoçikleta me targë {\*\*\*}, është deklaruar nga subjekti në d-vetting, trupi gjykues e konsideron jo të drejtë konkluzionin e Komisionit lidhur me motoçikletën me targë {\*\*\*}, e cila është deklaruar në d-vetting, në referim edhe të jurisprudencës së Kolegjit, sipas së cilës deklarimet objekt kontrolli, për të cilat subjektet mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë sipas ligjit nr. 84/2016, janë ato që bëhen në d-vetting, ndërsa e konfirmon qëndrimin e Komisionit për mosdeklarimin e motoçikletës me targë {\*\*\*}, e cila, ndonëse rezulton në pronësi të personit të lidhur në kohën e përpilimit të d-vetting, nuk është deklaruar prej tij në të, si një send në pronësi në përputhje me detyrimet ligjore. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerën e këtyre sendeve, nuk konsiderohet relevant nga Kolegji, për sa kohë deklarata e pasurisë nuk është e ndërvarur me vlerën e pasurive, por me detyrimin për deklarimin e çdo të drejtë pronësore. Vlera e kësaj pasurie ndikon në këtë rast në faktin që përcaktimi i shkeljes do të duhet të kryhet sipas deklarimit të pasaktë dhe jo fshehjes së pasurisë, ashtu si edhe ka vepruar Komisioni, duke qenë se duket se mungon një qëllim i posaçëm për këtë qëllim, edhe në mungesë të evidentimit të mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e saj.

**24.5** Në përfundim, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë vetting, duke mos deklaruar këtë pasuri në pronësi të tij sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

**25** *Subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e Komisionit se, duke mos deklaruar përdorimin e apartamentit të prindërve gjatë sezonit veror, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm dhe të pasaktë të pasurive. Lidhur me këtë shkak ankimi, Kolegji analizon sa vijon.*

**25.1** Komisioni, në rezultatet paraprake të hetimit, për të cilat i ka kaluar subjektit barrën e provës, ka parashtruar se: *Duket se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën “vetting” nuk ka deklaruar përdorimin e këtij apartamenti gjatë sezonit veror.* Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, i përgjigjet Komisionit, duke u shprehur se: *Ky apartament nuk është përdorur në vitin 2015, kur janë bërë shlyerjet e kësteve, por është përdorur në sezonin veror të vitit 2016 (disa ditë në muajin gusht), ndërkohë që deklarata “vetting” është dorëzuar vetëm 5 muaj më pas, në datën 29.1.2017. Duke qenë se ky apartament është përdorur vetëm disa ditë në gusht të vitit 2016 dhe ishte i pamobiluar, nuk është përmendur në deklaratën “vetting”.*

Në vendimin e Komisionit lidhur me përdorimin e apartamentit të prindërve në Vlorë, është konkluduar se: [...] *duke mos deklaruar përdorimin e këtij apartamenti gjatë sezonit veror, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm dhe të pasaktë të pasurive. Referuar pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit mbart detyrimin të deklarojë të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në zotërim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.*

**25.2** Në ankim, lidhur me përdorimin e apartamentit të prindërve në Vlorë, subjekti pretendon se ligji nr. 84/2016 dhe udhëzimi nr. 4095, datë 10.10.2016, i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, dalë në zbatim të ligjit, i përkasin ekskluzivisht procesit të rivlerësimit, dhe se deklarimi i marrëdhënies së posedimit apo përdorimit mbi pronën është vendosur si detyrim me ligjin nr. 84/2016, sepse më parë nuk ekzistonte. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting 2017* veprimet e kryera me apartamentin në pronësi të prindërve, të ndodhur në Vlorë, duke filluar qysh me veprimet e kryera për blerjen e apartamentit, në bazë të prokurës nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2015, që i kishin lënë prindërit P. B dhe V. B. Subjekti në ankim pretendon se Komisioni nuk ka konsideruar se për apartamentin në Vlorë, prindërit i kishin lënë prokurë për blerjen e kësaj prone, duke i lënë njëkohësisht edhe përgjegjësinë e administrimit dhe mirëmbajtjes së tij. Subjekti shpjegon se, në kuadrin e delegimit të së drejtës së dhënë nga prindërit, subjekti është ndodhur disa ditë, në muajin gusht 2016, në apartamentin në fjalë, i cili, duke qenë se ishte i porsablerë, ishte njëkohësisht edhe i pamobiluar.

**25.3** Në analizë të këtij pretendimi, Kolegji konstaton se marrëdhënia e subjektit me këtë pasuri, nuk mund të konsiderohet se është një e drejtë përdorimi që meriton të trajtohet si e tillë, në kuptim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Fakti i përdorimit vetëm për disa ditë i apartamentit të prindërve në muajin gusht, nuk konsiderohet prej Kolegjit se përmban elemente të mjaftueshme që do ta kualifikonin këtë raport si një të drejtë përdorimi, sipas parashikimit të ligjit. Marrëdhënia e subjektit me këtë pasuri duket sporadike dhe rastësore, pa arritur të prodhojë, të paktën deri në ditën e përpilimit të deklaratës *vetting*, një marrëdhënie juridike civile e cila duhej deklaruar si e tillë.

**25.4** Në këto rrethana, Kolegji e gjen të drejtë pretendimin e subjektit lidhur me këtë qëndrim të Komisionit dhe vlerëson se ai nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi sipas këtij ligji, për mosdeklarimin e kësaj marrëdhënieje si përdorim në deklaratën *vetting*.

**26** *Kolegji mori në shqyrtim gjithashtu pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me anë të të cilave ai kundërshton rezultatet e analizës financiare të Komisionit për vitet 2010 – 2016.*

Në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, nga analiza ekonomike e kryer, është konkluduar që subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi<sup>26</sup> për të mbuluar me të ardhura të ligjshme

<sup>26</sup> Nga analiza financiare e Komisionit për periudhën 2010-2016, subjekti ka rezultuar në pamundësi financiare të mbulimit të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme, në shifrat:

- viti 2010, me diferencë negative prej (-)836.200 lekësh;

- vitet 2011-2012, me diferencë negative prej (-)15.336.710 lekësh;

kostot e jetesës, shpenzimet e udhëtimit, pagesën e kësteve të kredisë, si dhe krijimin e likuiditeteve me të cilat ka kredituar llogaritë {\*\*\*} të fëmijëve të tij.

**26.1** Në ankim, subjekti kundërshton analizën ekonomike të kryer nga Komisioni për vitet 2010 -2016, duke pretenduar që të ardhurat që kanë mbuluar shpenzimet e jetesës, shlyerjen e kësteve të kredisë, si dhe shtesat në llogaritë {\*\*\*} të fëmijëve përgjatë periudhës 2009 - 2016, nuk mund të trajtohen në kuadër të ligjit për “Tatimet mbi të ardhurat”, pasi subjekti dhe bashkëshorti gjatë kësaj periudhe kanë qenë të pezulluar nga detyra, për shkak të një procesi penal të zhvilluar ndaj tyre, dhe llogaritja e këtyre shpenzimeve duhet të kryhet në përputhje me të drejtën universale për të jetuar. Në ankim, subjekti pretendon se në analizën financiare të kësaj periudhe, duhet të përfshihet shuma prej 6.898.417 lekësh, si e ardhur nga mbështetja e familjarëve dhe puna informale në kushtet e goditjes së familjes nga shteti, e përdorur për mbulimin e shpenzimeve të përditshme, këstit të kredisë në Raiffeisen Bank dhe për shpenzimet e pushimeve, si dhe shuma prej 317.700 lekësh, si e ardhur nga mbështetja e familjarëve pas vitit 2009, për fëmijët në llogarinë {\*\*\*} pranë Intesa Sanpaolo Bank.

**26.2** Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, Kolegji mori në analizë të dhënat e përftuara nga deklaratat periodike të pasurisë, si dhe nga d-*vetting*. Në deklaratat periodike të pasurisë për vitet 2010-2016, rezulton që subjekti të ketë deklaruar përshkrimin: “Të ardhura nga mbështetja e familjarëve dhe puna informale, në kushtet e goditjes së familjes nga shteti”, por nuk ka deklaruar vlera specifike të këtyre të ardhurave, siç kërkohet në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale”. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se: *[...] arsyeja se përse prej saj nuk janë deklaruar shifra në numra për mbështetjen e familjarëve pas vitit 2009 në deklaratimet periodike, ka të bëjë me faktin se janë konsideruar intimitet (privatësi) e familjes në një periudhë të vështirë që ka kaluar në ato vite (burrë e grua me dy fëmijë), të cilat nuk ka dëshiruar t’i reklamojë, duke menduar se ishin kurioziteti i tepërt, por jo se mund të vihej në diskutim një ndihmesë e tillë, e dhënë nga familjarët për jetesën e familjes së subjektit.* Qëndrimi i mbajtur nga subjekti në ankim është se mbështetja e familjarëve ka shërbyer për plotësimin e nevojave bazë të familjes dhe nuk ka qenë në kuadrin e dhuratave dhe trajtimeve preferenciale.

**26.3** Duke vijuar më tej me analizimin e d-*vetting*, Kolegji konstaton se edhe në këtë deklaratë, subjekti për të ardhurat e viteve 2010-2016, deklaron: *Të ardhura të familjes kanë qenë mbështetja e familjarëve dhe të ardhurat nga puna informale, në kushtet e goditjes së familjes nga shteti,* dhe përkrah këtij përshkrimi, në rubrikën tek e cila duhet deklaruar shuma e të ardhurës neto, nuk është deklaruar asnjë vlerë.

**26.4** Në analizë të kësaj situatë, Kolegji vëren se shumatat e pretenduara nga subjekti si të përfituara si ndihmë ekonomike ndër vite (2011 - 2015) nga prindërit dhe të afërmit, klasifikohen si dhurime të shumave monetare, të cilat nuk janë deklaruar në deklaratat periodike në vite si të tilla dhe as në formën e huas, nëse përfitimi i tyre do ishte me qëllimin e kthimit në një kohë të mëvonshme. Në formularin e deklarimeve periodike (DVP), në seksionin e “Të dhënave konfidenciale, dhuratave dhe trajtimeve preferenciale”, kërkohet që deklaruesit të përshkruajnë llojin e dhuratës, në vlerën mbi 10.000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe trajtime preferenciale nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Në këtë kuptim, deklarimi i këtyre shumave të përfituara gjatë kësaj periudhe nga subjekti në deklaratat periodike, ka qenë detyrim i cili duhej të deklarohet prej tij te rubrika e të dhënave konfidenciale, në versionin që ai pretendon se të dhënat ishin sensitive dhe intime. Deklarimi i vlerës së këtyre shumave nuk konsiderohet si një zgjedhje e subjekteve deklaruese nga ligji,

- 
- viti 2013, me diferencë negative prej (-)1.087.900 lekësh;
  - viti 2014, me diferencë negative prej (-)168.073 lekësh;
  - viti 2015, me diferencë negative prej (-)1.311.646 lekësh;
  - viti 2016, me diferencë negative prej (-)599.818 lekësh.

por si një detyrim ligjor i cili, për më tepër në procesin e rivlerësimit, do të përbënte një provë për sa subjekti deklaron dhe pretendon për fitimin e këtyre shumave.

Gjithashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka përmbushur këtë detyrim ligjor as në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi as në të nuk ka deklaruar vlerën dhe specifikimet e posaçme të këtyre shumave. Të njëjtën sjellje rezulton të ketë pasur subjekti edhe gjatë procesit të hetimit administrativ, pasi nga ana e tij nuk ka pasur një detajim të këtyre të ardhurave për të përcaktuar saktë burimin e tyre dhe për t'i justifikuar ato me dokumentacionin përkatës.

Subjekti ka deklaruar në një fazë të avancuar të hetimit administrativ, se këto të ardhura burojnë nga prindërit e tij me banim në ShBA, nga pensionet e tyre të përfituara në Shqipëri, dërgesa parash të sjella nga motra, dërgesa parash të sjella nga miq/të afërm gjermanë, të ardhura nga puna e tyre informale, të ardhura nga tezja e personit të lidhur, por në asnjë rast ajo nuk detajon shumat specifike dhe as burimet përkatëse. Kolegji vëren se subjekti pretendon për një total të ardhurash si kontribut nga familjarët, në vlerën 6,8 milionë lekë, shifër të cilën e bën prezente vetëm pas marrjes së rezultateve të hetimit dhe e justifikon mosdeklarimin e tij nëpër deklarata periodike me argumentin se këto janë konsideruar privatësi e familjes në një periudhë të vështirë ekonomike.

**26.5** Duke vlerësuar në tërësi situatën faktike në mënyrën që e paraqet subjekti në ankim, Kolegji konstaton se në kohën që ajo dhe bashkëshorti janë gjendur të papunë, ata kanë vijuar të kryejnë investime të rëndësishme për banimin, duke u zhvendosur në një apartament të ri, 197 m<sup>2</sup>, me një sipërfaqe dhe vlerë disa herë më të madhe nga ai ekzistues, i cili në momentin kur ata janë larguar nga detyra, ishte shlyer në 1/5 vlerë të tij sipas pretendimit të subjektit (*pra, paguar vetëm 40.000 euro*). Në këto kushte, Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit që këto ndihma janë dhënë për të siguruar ekzistencën e familjes dhe përballimin e shpenzimeve jetike në kushtet e papunësisë së bashkëshortëve, duket i paarsyeshëm dhe jobindës, për sa kohë që pikërisht përgjatë kësaj periudhe, subjekti ka vazhduar të kryejë pagesa për shpenzime që dalin nga kategoria e tyre jetike.

**26.6** Së fundmi, Kolegji, në funksion të analizimit të këtij shkak, evidenton se subjekti i rivlerësimit vetëm pasi është njohur me rezultatet paraprake të hetimit, ka evidentuar një shifër të ndihmës në total, të përfitur si kontribut në likuiditete nga familjarët e saj. Kjo shifër (6.898.417 lekë) është e tillë sa mund të kompensojë diferencën negative të evidentuar në analizën ekonomike të kryer nga Komisioni për vitet 2010-2016. Por sërish, edhe për këtë shifër të evidentuar si kontribut i familjarëve, subjekti nuk e ka detajuar atë duke e ndarë se cilat fonde vijnë nga kush, si dhe as tenton të provojë në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre shumave. Kjo mënyrë deklarimi, por edhe trajtimi në ankim, e pamundëson kontrollin e këtyre deklarimeve të subjektit lidhur me mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

**26.7** *Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën e vitit 2012, duhet të përfshihen të ardhurat e siguruar (si dhuratë në cash) nga shtetasja Zh. S. M<sup>27</sup>, në vlerën 2.800 euro, shumë e cila ka shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të pushimeve, Kolegji analizon sa vijon.*

**26.8** *Në vendimin e Komisionit, në paragrafin 12.5, lidhur me elementet e përfshirë në analizën financiare pasqyrohet se: [...] (5) Të ardhurat (dhuratë cash) nga shtetasja Zh. M, tezja e bashkëshortit të subjektit, për pushimet, në shumën 2.800 euro, nuk janë konsideruar në analizën financiare, për sa kohë që kryerja e kësaj pagese prej të afërmeve nuk është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore, në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale”.*

**26.9** Lidhur me këtë qëndrim të Komisionit, subjekti në ankim pretendon se: *Zh. M, nga Gjermania, ka prenotuar dy dhoma hoteli në {\*\*\*} për familjen e personit të lidhur (nipit –*

---

<sup>27</sup> Tezja e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

A. P) dhe të nipit tjetër (L. P) të saj dhe se subjekti nuk ka pasur dijeni mbi shifrën e saktë të shpenzuar prej tezes së bashkëshortit. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo është arsyeja që kjo shumë nuk është deklaruar në DVP-në e vitit 2012, në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale”.

Sipas subjektit, vlera 2.800 euro u bë e ditur prej tij, gjatë procesit të hetimit administrativ, kur, për shkak të procesit të rivlerësimit, ai u detyrua të pyeste znj. Zh. M për këto shpenzime. Subjekti<sup>28</sup> pretendon që ky shpenzim është real dhe i mbuluar prej tezes së bashkëshortit dhe, për të provuar këtë fakt, ka depozituar një *statement* bankar nga Post Bank Gjermani, ku pasqyrohen lëvizjet e llogarive bankare të vitit 2012 dhe ku konstatohet prenotimi me përshkrim në gjuhën gjermane.

**26.10** Nga analizimi i provave të përcjella nga subjekti përgjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se pagesa e pjeshme, në shumën 400 euro, është bërë nga teza e personit të lidhur për pagimin e akomodimit në hotel. Kjo vlerë, dhe jo ajo e pretenduar prej subjektit, prej 2.800 eurosh, është e vetmja e cila mund t'i nënshtrohet analizës financiare në versionin nëse pranohet pretendimi i subjektit për dhurimin e saj. Diferenca e pretenduar prej subjektit mbetet deklarative sepse ajo është e padokumentuar, por edhe e padeklaruar në deklaratën periodike të vitit 2012 si një dhuratë e përfutur prej familjes së tij. Pavarësisht mungesës së provueshmërisë për këtë përfitim, edhe në versionin se vlera prej 400 eurosh konsiderohet si e ardhur në analizën financiare të kryer në Kolegj, rezultati negativ për subjektin mbetet përsëri i thellë dhe i pandikueshëm prej saj.

**26.11** Nga sa parashtruar më sipër, Kolegji, pasi shqyrtoi shkaqet e ankimit lidhur me këtë çështje, verifikoi rrethanat e faktit që e ndikojnë atë dhe kreu analizën financiare për periudhën e përshkruar më lart, konfirmoi rezultatet negative të analizës financiare të Komisionit, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme, respektivisht: në vitin 2010, shumën prej (-)836.200 lekësh; në vitet 2011-2012<sup>29</sup>, shumën prej (-)13.883.622 lekësh (duke marrë në konsideratë dhurimin prej 400 eurosh, dhënë nga teza Zh. M, për pushime të familjes së subjektit); në vitin 2013, shumën prej (-)1.087.900 lekësh; në vitin 2014, shumën prej (-)168.073 lekësh; në vitin 2015, shumën prej (-)1.311.646 lekësh; dhe në vitin 2016, shumën prej (-)599.818 lekësh.

**26.12** Në këto kushte, Kolegji, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve për vitet 2010, 2011-2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 27** Në vlerësim dhe analizë të konkluzioneve të mësipërme, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, i gjendur në situatat e mësipërme të shkeljes së ligjit, nuk arrin të përmbushë kriteret kushtetuese për arritjen e një niveli të besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pikat 1, 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe se konkluzionet e mësipërme e kualifikojnë atë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke përcaktuar për pasojë, në mënyrë detyruese, zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra. Për pasojë, vendimi nr.

---

<sup>28</sup> Subjekti ka paraqitur me ankimin, si provë të re, dokumentin e *statement-it* bankar të znj. Zh. M, që tregon pagesën e kryer për pushimet e familjes P., të mbërritur me vulë apostile pas dhënies së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi. Ky *statement* bankar, i paguar nga Zh. M, tregon për një pagesë në favor të {\*\*\*}, në shumën 400 euro.

<sup>29</sup> Diferenca negative e vitit 2012, prej (-) 13.883.622 lekësh është e ndryshme nga diferenca që rezulton në vendimin e Komisionit prej 15.336.710 lekësh, pasi nga ana e Kolegjit janë njohur detyrimet e lindura nga kontrata e huas nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*}kol., datë 03.10.2012, me shoqërinë {\*\*\*} ShPK, mbi njohjen e një detyrimi prej 10.000 eurosh, i cili do të shlyhet në vijim.

228, datë 17.01.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është marrë mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 228, datë 17.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Balili.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 11.04.2022

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*